


# Ushtrimi i të drejtave individuale të grave për të votuar një domosdoshmëri demokratike



Integrated projects



COUNCIL OF EUROPE  
CONSEIL DE L'EUROPE

# **Ushtrimi i të drejtave individuale të grave për të votuar – një domosdoshmëri demokratike**

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës

Projekti Funksionimi i institucioneve demokratike

Këshilli i Evropës

Edicioni në Anglisht:

*Women's individual voting rights – a democratic requirement*

ISBN 92-871-5040-0

Edicioni në Frëngjisht:

*Le droit de vote individuel des femmes: une exigence démocratique*

ISBN 92-871-5037-7

*Versionet në gjuhën Anglisht dhe Frëngjisht të këtij rekomandimi janë versione zyrtare të teksteve të Këshillit të Evropës. Përkthimi në gjuhën shqipe është version jo-zyrtar.*

(The Albanian version is an unofficial translation.)

*Ky tekst botohet me mbështetjen e projektit të integruar të Këshillit të Evropës  
“Making democratic institutions work”*

*<http://www.coe.int/democracy>*

Dizenjimi i kopertinës: Njësia e Dizenjimeve, Këshilli i Evropës  
F-67075 Strasbourg Cedex

© Conseil de l'Europe, 2003  
Shtypur në Këshillin e Evropës

**Këshilli i Evropës** u themelua në vitin 1949 për të vendosur unitet më të madh midis demokracive Evropiane Parlamentare. Është institucioni më i vjetër politik Evropian dhe ka 48 shtete anëtare, duke përfshirë 15 vende anëtare të Bashkimit Evropian. Është organizata më e gjërë ndërqeveritare dhe ndërparlamentare në Evropë dhe ka selinë e saj në Strasburg.

Këshilli i Evropës ka theksuar gjithmonë rëndësinë primare të demokracisë në nivel lokal dhe rajonal dhe se liria është jo vetëm çështje kombëtare, por edhe një çështje që ka të bëjë me fqinjët.<sup>1</sup> Vetëqeverisja lokale duhet të plotësojë nevojat e të gjithë Evropianëve në qytete dhe fshatra, në rajone qendrore dhe periferike si dhe në nivel ndërkufitar.

Në vitin 1994 Këshilli i Evropës krijoi **Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës** (CLRAE). Ai përbëhet nga dy dhoma, Dhoma e Autoriteteve Lokale dhe Dhoma e Rajonave dhe ka më tepër se 300 anëtarë të zgjedhur, që përfaqësojnë autoritetet lokale dhe rajonale nga 44 vende anëtare të Këshillit të Evropës.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Kongresit është të ndihmojë vendet e reja anëtare në aspektet praktike të krijimit të vetëqeverisjes së efektshme lokale dhe rajonale, veçanërisht vendet e reja anëtare dhe ato kandidatet. Kjo përfshin:

- sigurimi i një forumi ku përfaqësuesit lokal dhe rajonal të mund të shprehin pikpamjet e tyre ndaj qeverive;
- këshillimin e Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në të gjitha aspektet e politikës lokale dhe rajonale;
- organizimi i seancave dëgjimore dhe konferencave për të tërhequr interesimin e publikut, përfshirja e të cilit është me rëndësi themelore për një demokraci funksionale;
- përgatitja e raporteve të veçanta për gjëndjen e demokracisë si në vendet anëtare ashtu dhe në ato kandidatet;
- monitorimi i zbatimit të Kartës Evropiane të Qeverisjes Lokale dhe Vetëqeverisjes.

---

1. Shqipëria, Andora, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republike Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lihteshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Moldoavia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Federata Ruse, San Marino, Republika Sllovaqe, Spanja, Suedia, Zvicra, "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Ukraina, Britania e Madhe.

Një objektivi tjetër i Këshillit është të nxisë shkëmbimin e përvojave të<sup>1</sup> praktikave të mira dhe kompetencave të qeverisjes lokale dhe, po të jetë e mundur, arritja e konsensusit.

# Përmbajtja

	<i>Page</i>
<b>Parathënie</b> .....	7
<b>I. Ushtrimi i të drejtave individuale të grave për të votuar – një domosdoshmëri demokratike</b> .....	9
<b>II. Shembuj të votimit familjar</b> .....	27
Shqipëria .....	27
Armenia .....	31
Azerbajxhani .....	32
Bosnja dhe Hercegovina .....	33
Bullgaria .....	35
Kroacia .....	36
Estonia .....	37
Gjeorgjia .....	37
Hungaria .....	38
Letonia .....	39
Lituania .....	40
Moldavia .....	42
Polonia .....	43
Rumania .....	43
Federata Ruse .....	43
Republika Sllovaqe .....	45
“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” .....	45
Ukraina .....	49
Republika Federale e Jugosllavisë .....	50
<b>Shtojce: Rekomandimi 111 (2002) për ushtrimin e të drejtave të grave për votim – një domosdoshmëri demokratike</b> .....	53
<b>Referenca</b> .....	59



## Parathënie

Vëzhgimet që Asambleja Parlamentare dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës si dhe Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë kanë bërë që nga viti 1995 kanë treguar se votimi familjar ndodh në shumë vende të territorit Evropian. Votimi familjar ndodh kur një anëtar mashkull i familjes voton për një apo më shumë pjestarë gra të familjes.

Ky veprim i ka rrënjët në mentalitete dhe praktika, që u mohojnë grave të drejta të barabarta dhe të plota qytetare me burrat, si dhe favorizohet nga zyrtarë zgjedhorë që nuk pranojnë të zbatojnë plotësisht ligjet elektorale.

Duke tërhequr vëmendjen ndaj karakterit të vazhdueshëm të kësaj praktike, Kongresi theksoi nëpërmjet rekomandimit të tij dhe memorandumit shpjegues se e drejta e grave për votë individuale dhe të fshehtë është një tipar themelor i demokracisë, që nuk mund të vihet në dyshim. Votimi familjar është gjithashtu i papranueshëm në kuadrin e të drejtave themelore të grave në vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Lufta kundër kësaj praktike të vazhdueshme në një demokraci kërkon përpjekje të përbashkëta nga autoritetet publike dhe organizatat jo-qeveritare si dhe ndryshime në mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve.

*Ushtrimi i të drejtave individuale të grave për votim – një domosdoshmëri demokratike* propozon një seri masash për të luftuar votimin familjar dhe për të përmisuar pjesmarrjen e grave në jetën publike dhe politike. Këto masa mund të zbatohen nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës si dhe organet apo grupet e saj të punës, si Komiteti Drejtues i Barazisë midis Grave dhe Burrave, Asambleja Parlamentare, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, Komisioni i Venicias, si dhe organizatat jo-qeveritare.

Kongresi shpreson se kjo broshurë do të nxisë aktivitete në terren, të cilat mund të përhapen në shumë vende në mënyrë që të sigurohet respektimi i të drejtës së grave për votim të fshehtë, të lirë dhe individual. Ajo do të përkthehet në shume gjuhë dhe do të shpërndahet në vendet ku votimi familjar është problem. Ajo do të përdoret gjithashtu si dokument bazë për identifikimin e praktikave të mira, duke nxitur organizimin e veprimtarive për rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e votimit familjar.



Ky botim është një kontribut në projektin e integruar “Funksionimi i institucioneve demokratike.” Ky projekt filloi në vitin 2002 për t’ju përgjigjur një prej sfidave kryesore me të cilat ballafaqohet Evropa sot – mbështjetja dhe dialogu i institucioneve demokratike me të gjithë popujt e Evropës, duke përfshirë grupe që, për arsye të ndryshme, kanë qënë të përjashtuar nga pjesmarrja e barabartë në proceset demokratike. Barazia gjinore është prioritet në të gjitha aktivitetet e projektit.

# **I. USHTRIMI I TË DREJTAVE INDIVIDUALE TË GRAVE PËR TË VOTUAR – NJË DOMOSDOSHMËRI DEMOKRATIKE**

## **Hyrje<sup>1</sup>**

Votimi familjar nënkupton praktika votimi në të cilat grave u privohet e drejta për votim. Ai ndeshet në tre forma: në votimin në grup, ku një anëtar mashkull i familjes shoqëron një ose më tepër gra anëtare të familjes në dhomën e fshehtë të votimit; në votimin e hapur, ku grupe familjare votojnë sëbashku hapur; dhe në pseudo-votimin, ku një anëtar mashkull i familjes grumbullon fletët e votimit që ligjërisht i përkasin një apo më shumë anëtarëve femra të familjes dhe voton sipas dëshires së tij. Kjo sjellje lind nga mentalitete dhe praktika, të cilat u mohojnë grave të drejtat të plota dhe të barabarta qytetare me burrat. Ajo favorizohet nga zyrtarë elektoralë, të cilët nuk zbatojnë siç duhet ligjet elektorale.

Raporte të vëzhguesve të pavarur zgjedhorë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale Evropiane (CLRAE), si dhe të Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) e identifikojnë votimin familjar si fenomen që ndodh në disa pjesë të kontinentit Evropian, kryesisht në disa ish shtete të Bashkimit Sovjetik (shih shtojcën). Kjo praktikë u soll në vëmendje të Byrosë së Këshillit të Evropës nga delegacioni i Kongresit, që vizitoi zgjedhjet lokale në “ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë” më 10 dhe 24 shtator 2000. Më pas, Komiteti i CLRAE-s për Kohezionin Social, në takimin e tij më 23 Mars 2001, theksoi rëndësinë primare që ka në një demokraci e drejta e gruas për votim individual, të lirë dhe të fshehtë. Komiteti shprehu mendimin se problemi i votimit familjar, i konstatuar në disa vende të Evropës, ishte i papranueshëm nga pikpamja e të drejtave themelore të grave.

Mbrojtja e të drejtave individuale për votim është një element bazë për demokracinë dhe është sanksionuar në kushtetutat e vëndeve anëtare të Këshillit të Evropës. Këto dispozita kushtetuese parashikojnë qartësisht të drejtën universale të të gjithë qytetarëve mbi moshën 18 vjeç, zgjedhje të

---

1. Ky raport është përgatitur nga Diane Bunyan (Mbretëria e Bashkuar), Anëtare e Komitetit të Kongresit mbi Kohesionin Social. Yvonne Galligan (anëtare e Grupit të Specialistëve për Pjesëmarrjen e Ekuilibruar të Grave dhe Burrave në vendim-marrjen politike dhe publike), kontriboi në përgatitjen e këtij raporti.

drejtpërdrejta dhe të lira për ku vëndet parlamentare dhe lokale, si dhe votim të fshehtë. Shumë kushtetuta shkojnë edhe më tej duke u garantuar grave të drejta të barabarta politike, qytetare, sociale, kulturore, dhe ekonomike me burrat (Tabela 1). Nga këto parime bazë burojnë ligje dhe rregulla elektorale. Përveç kësaj, e drejta e grave për të ushtruar të drejtën e tyre për votim mbrohet nga e drejta ndërkombëtare (Neni 7, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave). Të gjitha vëndet e ratifikuara, si minimum, e kane ratifikuar konventën, dhe janë ligjërisht të detyruara të vënë në praktikë dispozitat e saj. Kjo e bën Nenin 7, i cili garanton të drejtat politike të grave, të zbatueshëm në vëndet anëtare.

Megjithatë, mentalitete, të cilat reflektojnë mbizotërimin e patriarkalizmit ndaj demokracisë në disa vënde anëtare, bëjnë që grave t'u mohohet e drejta për votim. Problemi është i qartë në vëndet anëtare me struktura relativisht të reja politike demokratike, ndryshe nga vëndet me demokraci të vjetër ku e drejta individuale për votim është e ngulitur mirë. Ky transgresion i ligjit ndërkombëtar, kushtetues, dhe elektoral bën që shumë qytetare gra të privohen nga e drejta e tyre për votim. Ai konfirmon, në mënyrë shumë të qartë, konkluzionin e Grupit Specialist për Barazinë dhe Demokracinë i Këshillit të Evropës se “vlera dhe dinjiteti i barabartë i grave dhe burrave, megjithëse është sanksionuar në legjislacionin e shumicës së vendeve, ende nuk zbatohet plotësisht *de facto*”.<sup>1</sup> Kjo dëmton funksionimin e pjesmarrjes demokratike dhe minon legjitimitetin që demokracitë e reja pluraliste po përpiqen të arrijnë. Siç thekson deklarata e miratuar në Konferencën e 4 Ministeriale Evropiane për Barazinë midis Grave dhe Burrave:

Skajëzimi i grave në jetën publike dhe demokraci është një faktor strukturor që lidhet me shpërndarjen e pabarabartë të pushtetit ekonomik dhe politik midis grave dhe burrave dhe me qëndrime stereotipe lidhur me rolet sociale të grave dhe burrave. Këto role sociale stereotipe kufizojnë mundësinë si të grave ashtu dhe të burrave për të përdorur tërë potencialin e tyre.<sup>2</sup>

## **Shkalla e problemit**

Votimi familjar është një problem që deri më sot nuk është përmëndur në dokumentet e Këshillit të Evropës për barazinë gjinore në vendim-marrje.

1. Raporti final i Grupit të Specialistëve për Barazinë dhe Demokracinë, EG (97) 1, p. 4.

2. Deklarata për Barazinë midis Grave dhe Burrave si Kriter Themelor për Demokracinë (Stamboll 1997). MEG-4 (97) 18.

Dokumentat e shumta që trajtojnë këtë problem pranojnë se grave u është dashur të zhvillojnë një luftë të gjatë dhe të vështirë për të fituar të drejtën për votë, por supozojnë se meqe gratë e kanë fituar këtë të drejtë ato janë të lira t'a ushtrojnë atë. Në këtë dokumenta diskutimi mbi barazinë gjinore fokusohet në masat për eliminimin e formave të tjera të shumta të diskriminimit ndaj gruas.

Një vlerësim i raporteve zgjedhore të vëzhguesve të pavarur nga Këshilli i Evropës dhe OSBE tregon se nga viti 1995 deri në vitin 2001 votimi familjar u identifikua si një fenomen i vazhdueshëm në 16 vende Evropiane (shih shtojcën). Shkalla e problemit varionte nga një vend në tjetrin si dhe nga zgjedhjet në zgjedhje: votimi familjar u konstatua rrallë në Poloni dhe Bullgari, dhe ishte një fenomen i parëndësishëm në Hungari. Me kalimin e kohës votimi familjar u duk se u zvogëlua në Gjeorgji, por ai vazhdoi të ishte një praktikë e përhapur në vëndet e tjera ish-Sovjetike. Shpjegimet që iu dhanë vëzhguesve elektorale për votimin familjar kishin të bënin me qëndrime dhe tradita lokale, sipas të cilave fakti që burrat flisnin dhe vepronin në emër të grave për probleme publike dhe politike konsiderohej normal. Në zona të tjera, praktika e votimit familjar lidhej me ekzistencën e kulturave mbi baza etnike. Në zona të tjera, votimi familjar u identifikua si fenomenon post-komunist, dhe jo si një fenomen etnik. Nga raportet e vëzhguesve del se votimi familjar u konstatua kryesisht në komunitetet rurale. Në shumë raste zyrtarët zgjedhore përpiqeshin shumë pak të ndalonin këtë praktikë - megjithëse ishte një shkelje e ligjeve elektorale dhe kushtetuese. Disa vëzhgues e trajtonin gjithashtu votimin familjar si një problem i një rëndësie më të vogël se sa shkelje të tjera të procesit elektorale.

Si një hap të parë për të trajtuar këtë problem, u analizua pozita kushtetuese lidhur me të drejtën e votimit dhe barazinë midis grave dhe burrat në vëndet anëtare ku u konstatua votimi familjar. U analizua gjithashtu shkalla e zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Në Tabelën 1 jepet një përmbledhje e konkluzioneve.

Duke patur parasysh dispozitat kushtetuese dhe angazhimin ndaj CEDAW të përmbledhura në Tabelën 1, ekzistenca e votimit familjar nuk ka baze ligjore. Megjithatë, zakonet, traditat dhe mentalitetet lokale për rolin qytetar të gruas kanë kontribuar në privimin e vazhdueshëm të grave në shumë vënde ish-komuniste nga e drejta për votim.

**Tabela 1: Dispozita kushtetuese për barazi dhe të drejtën për votim në vëndet anëtare të Këshillit të Evropës, dhe zbatimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)**

Vëndet anëtare	Constitution	CEDAW
Shqipëria	Art. 1: Zgjedhje të lira Art. 3: Mbrojtja e të drejtave të njeriut Art. 18: Jo-diskriminim për ndonjë arsye të përmëndur (duke përfshirë seksin) Art. 45: E drejta për votë, votë të fshehtë	A. 11.5.94
Armenia	Art. 3: Zgjedhje, votë e fshehtë Art. 4: Mbrojtja e të drejtave të njeriut Art. 16: Barazi para ligjit (e përgjithshme)	A. 13.9.93
Azerbajxhani	Art. 2: Zgjedhje, votë e fshehtë Art. 25: Barazi midis grave dhe burrave Art. 54: E drejta për të marrë pjesë në jetën politike Art. 55: E drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit Art. 56: E drejta e qytetarëve për të votuar	A. 10.7.95
Bosnja dhe Herzegovina	Art. 1: Zgjedhje të lira, demokratike Art. 2: Të drejtat e njeriut dhe jo-diskriminim për ndonjë arsye të përmëndur (duke përfshirë seksin)	D. 1.9.1993
Bullgaria	Art. 6: Jo-diskriminim për ndonjë arsye të përmëndur (duke përfshirë seksin) Art. 10: Zgjedhje, votë e fshehtë Art. 42: E drejta e qytetarëve për të votuar	C. 8.2.82
Kroacia	Art. 14: Të drejta të barabarta (grupet të përmëndura) Art. 45: E drejta për votë, votë të fshehtë	D. 9.9.92
Estonia	Art. 12: Jo-diskriminim për ndonjë arsye të përmëndur (duke përfshirë seksin) Art. 56: E drejta e qytetarëve për të votuar Art. 57: Moshë e votimit Art. 60: Zgjedhje parlamentare, votë e fshehtë Art. 156: Zgjedhje për pushtetin lokal, votë e fshehtë	A. 21.10.91
Gjeorgjia	Art. 7: Mbrojtja e të drejtave të njeriut (në përgjithësi) Art. 14: Barazia para ligjit, arsye të përmëndura (duke përfshirë seksin) Art. 28: E drejta për të votuar Art. 49: Zgjedhje parlamentare, votë e fshehtë	A. 26.10.94

*Ushtrimi i të drejtave individuale të grave për të votuar – një domosdoshmëri demokratike*

Hungaria	Art. 8: Mbrojtja e të drejtave të njeriut (ne përgjithësi) Art. 56: Barazi midis burrave dhe grave Art. 66: Barazi midis grave dhe burrave Art. 70: Zgjedhje, votë e fshehtë Art. 70A: Jo-diskriminim për ndonjë arsye të përmëndur (duke përfshirë seksin); dënim për diskriminim; shanse të barabarta Art. 71: Votim i fshehtë	C. 22.12.80
Letonia	Art. 6: Zgjedhje parlamentare, votë e fshehtë Art. 8: Mosha e votimit Arts. 89-91: Mbrojtja e të drejtave (në përgjithësi)	A. 14.4.92
Lituania	Art. 29: Barazi, mbrojtjet e përmëndura (duke përfshirë seksin) Art. 34: E drejta e qytetarëve për të votuar Art. 55: Votim i fshehtë për parlamentin kombëtar Art. 119: Votim i fshehtë për pushtetin lokal	A. 18.1.94
Moldavia	Art. 2: Sovraniteti popullor Art. 4: Mbrojtja e të drejtave të njeriut Art. 16: Barazia para ligjit, arsye të përmëndura (duke përfshirë seksin) Art. 38: Votim i fshehtë, e drejta për të votuar	A. 1.7.94
Polonia	Art. 32: Barazia para ligjit (ne përgjithësi) Art. 33: Të drejta të barabarta të burrave dhe grave; shanse t ë barabarta midis burrave dhe grave, duke përfshirë mbajtjen e posteve Art. 62: E drejta për votë Art. 96: Votim i fshehtë për zgjedhje parlamentare Art. 97: Votim i fshehtë për zgjedhje në Senat Art. 169: Votim i fshehtë për zgjedhje lokale	B. 30.7.80
Rumania	Art. 4: Jo-diskriminim për ndonjë arsye të përmëndur (duke përfshirë seksin) Art. 16: Barazi para ligjit Art. 34: E drejta për votim Art. 59: Votë e fshehtë Art. 120: Zgjedhjet të pushtetit lokal	B. 7.1.82
Federata Ruse	Art. 2: Mbrojtja e të drejtave të njeriut Art. 19: Barazi e të drejtave, arsyet e përmëndura (duke përfshirë seksin); të drejta dhe shanse të barabarta midis grave dhe burrave Art. 32: E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organe të pushtetit Art. 81: Votë e fshehtë për zgjedhje presidenciale Art. 96: Zgjedhjet në Duma	C. 23.1.81

Republika Sllovaqe	Art. 11: Traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë kryesore Art. 12: Barazi; Garanci për të drejtat për kategoritë e përmëndura (duke përfshirë seksin) Art. 30: Votë e fshehtë dhe e drejta e barabartë për të votuar	D. 28.5.93
“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”	Art. 8: Njohja e të drejtave të qytetarëve Art. 9: Barazi para ligjit, arësytet e përmëndura (duke përfshirë seksin) Art. 22: E drejta për votë, votë të fshehtë	D. 18.1.94
Ukraina	Art. 3: Garantimi i të drejtave të njeriut Art. 21: Barazia (në përgjithësi) Art. 24: Jo- diskriminim për ndonjë arësye të përmëndur (duke përfshirë seksin); equal opportunities between women and men Art. 70: E drejta për të votuar Art. 71: Votë e fshehtë	C. 12.3.81

*Për CEDAW: A= Ratifikim; B = Deklarata/rezerva; C= Rezervat me pas të tërhequra; D= Pasuar nga Burimet: [www.psr.keele.ac.uk/const.htm](http://www.psr.keele.ac.uk/const.htm), konsultuar më 2 Dhjetor 2001; [www.un.org/womenwatch](http://www.un.org/womenwatch), konsultuar më 4 Dhjetor 2001.*

Është e rëndësishme të jepen disa shpjegime politike dhe sociale për problemin e votimit familjar. Vecanërisht, duket se qendron, deri në një farë shkalle, argumenti për ekzistencën e “demokracisë jo të plotë”, i cili sugjeron se praktikatat e votimit në demokracitë e reja pluraliste nuk janë aq të ngulitura sa në demokracitë e konsoliduara dhe, për këtë arsye, parimi themelora është një person – një votë, i mbështetur në votën e fshehtë individuale, nuk është asimiluar ende plotësisht në praktikatat zgjedhore.

Arsyetimi i dytë i përmëndur në disa raste sugjeron se gratë janë më pak të arsimuara se sa burrat dhe, për këtë arsye, kanë nevojë për t’u ndihmuar kur votojnë. Ky shpjegim reflekton një mentalitet të ngulitur për rolin social të gruas, sipas të cilit aktivitetet politike dhe publike janë punë e burrave. Testimi i plotë i këtij shpjegim do të kërkonte grumbullimin e shume të dhënave të hollësishme mbi bazë vendi, i specifikuar sipas rajonit dhe origjinës etnike. Kjo është jashtë qëllimeve të këtij studimi. Megjithatë, një analizë e treguesve gjinore makro sugjeron se megjithëse gratë janë më pak të privilegjuara se burrat në jetën ekonomike, politike, dhe sociale, ato janë të pranishme në vëndet e punës dhe në vendimmarrje, dhe se ato janë po aq të arsimuara sa edhe burrat (shih Tabelën 2). Me përjashtim të Moldavisë, gratë e fituan të drejtën për të votuar në fillim ose në mes të shekullit 20-të. Gratë

**Tabela 2: Pabarazitë politike, arsimore, dhe ekonomike midis grave dhe burrave, 2000**

Vëndet anëtare	E drejta e grave per votim	Ligjberes femra	Ligjberes femra, zyrtare te larte dhe drejtues (% e totalit)	Femrat ne fuqine puntore ne %	Te ardhurat e femrave ne raport me ato te meshkujve (%)	Niveli i analfabetizmit ne in %	
						Bur	Gra
Shqipëria	1920	6	-	41	-	9	23
Armenia	1921	3	-	48	-	1	3
Azerbajxhani	1921	11	-	43	-	-	-
Bosnja dhe Hercegovina	1949	7	-	38	-	2	12
Bullgaria	1944	26	-	48	-	1	2
Kroacia	1945	21	26	44	55	1	3
Estonia	1918	18	35	49	63	-	-
Gjeorgjia	1918, 1921	7	-	47	-	-	-
Hungary	1918	8	34	45	57	1	1
Letonia	1918	17	39	50	65	0	0
Lithuania	1921	11	39	48	67	0	1
Moldavia	1978, 1993	13	-	49	-	1	2
Polonia	1918	20	34	46	61	0	0
Rumania	1929, 1946	11	26	44	58	1	3
Federata Ruse	1918	8	37	49	63	0	1
Republice Sllovak	1920	13	32	48	65	-	-
“Ish Republika Jugosllave e Maqedonise”	1946	7	-	42	-	-	-
Ukraina	1919	8	38	49	54	0	1

Shënimi: -do te thote se nuk kishte informacion.

Burimi: Treguesit e OKB-së për Zhvillimin Njerëzor në Raportin e OKB-së për Zhvillimin Njerëzor 2001 në [www.undp.org/ehdr2001](http://www.undp.org/ehdr2001), konsultuar në 12 Dhjetor 2001; Baza e të dhënave e Bashkimit Ndërparlamentar për gratë në parlament në [www.ipu.org](http://www.ipu.org), konsultuar në 12 Dhjetor 2001; Statistika të Bankës Botërore në [www.gendstats.worldbank.org](http://www.gendstats.worldbank.org).



janë të pranishme në nivelet e vendim-marrjes në jetën politike dhe ekonomike, ofrojnë shembuj për rolin e tyre dhe zënë hapësirë publike. Megjithatë aftësia e grave për të siguruar të ardhura është sa gjysma deri në dy të tretat në krahasim me ato të burrave, të paktën gjysma e grave të moshës së punës janë të punësuar. Përveç kësaj, me përjashtim të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe, në një shkallë më të vogël, Rumanisë, nivelet e arsimimit të grave janë të njëjta me ato të burrave.

Pra, treguesit e mësipërm përforcojnë mendimin se votimi familjar është një problem në zona specifike, dhe, ndoshta, ndër grupet e veçanta etnike në Evropë, kur profili socio-ekonomik i grave mund të mos jetë aq i përparuar, siç tregohet në Tabelën 2. Për këtë arsye, çdo nismë për t'a trajtuar këtë problem duhet të bazohet në studime specifike për vendin përkatës, të cilat duhet të identifikojnë shkaqet themelore të votimit familjar dhe kushtet e veçanta gjeografike dhe sociale në vendet ku ky fenomen është problem.

### **Trajtimi i problemit**

Votimi familjar është një çështje e vështirë dhe delikate. Ai kërkon vëmendje nga shumë aktorë, duke përfshirë Këshillin e Evropës, vendet anëtare të Këshillit të Evropës, organizatat jo-qeveritare, që kontribuojnë në forcimin e demokracisë, dhe organizatat që japin asistencë për trajnim për zgjedhje. Një problem në trajtimin e kësaj çështje është vështirësia në monitorimin e pavarur të zgjedhjeve në vendet anëtare të Këshillit të Evropës për të konstatuar nëse kjo praktikë është në rënie. Po kaq problematik është të bindësh, në disa raste, qeveritë e vendeve anëtare për të pranuar se ky fenomen ekziston në juridiksionin e tyre. Kjo mund të shpjgohet, pjesërisht, me faktin se autoritetet qeverisëse nuk dëshirojnë të pranojnë se gratë janë viktimat të paragjyqimeve dhe stereotipeve, të cilat i detyrojnë të jenë në pozita të varura qytetërisë. Ato e justifikojnë fenomenin me shpjgime të gatshme për “mentalitetet e izoluarat kulturore”, çka tregon shkallen e mungesës serioze në trajtimin jo-objektiv të tij. Megjithatë, e drejta individuale e grave për të votuar lirisht dhe fshehtas duhet të pranohet në të gjitha shoqëritë demokratike dhe moszbatimi i saj çon në dështim të praktikave demokratike elektorale dhe reduktim të legjitimitetit demokratik të qeverive (kombëtare, rajonale ose lokale). Siç thekson Platforma për Veprim e Kombeve të Bashkuara e miratuar në Pekin:<sup>1</sup>

---

1. Deklarata dhe Platforma e Pekinit për Veprim, miratuar nga Konferenca e Katert e OKB-se për Grate (Pekin, 1-15 Shtator 1995), f. 109

Rritja e rolit dhe autonomisë së grave dhe përmisimi i statusit social, ekonomik, dhe politik i grave është me rëndësi themelore për qeverisje dhe administrim transparent dhe të përgjegjshëm si dhe për zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha fushat e jetës... pa pjesëmarrjen aktive të grave dhe përfshirjen e opinioneve të grave në të gjitha nivelet e vendim-marrjes, objektivat e barazisë, zhvillimit dhe paqes nuk mund të arrihen.

Duke patur parasysh çka më sipër, për eliminimin e praktikës së votimit familjar janë ofruar rekomandimet e mëposhtme, të cilat mund të merren në konsideratë.

### *Këshilli i Evropës*

Këshilli i Evropës është në një pozitë të fortë për të mbështetur respektimin e standarteve më të larta të praktikave elektorale demokratike në vendet anëtare dhe mund t'a bëjë këtë nëpërmjet një sërë nismash që synojnë të mbështesin kapacitetin demokratik institucional dhe individual. Këto nisma përshkruhen më poshtë:

1. Duke punuar nëpërmjet Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës Këshilli i Evropës mund të inkurajojë binjakëzimin e qeverive lokale dhe rajonale midis vendeve anëtare si mjet, ndër të tjera, për të mbështetur praktikën më të mira demokratike elektorale. Binjakëzimi mund të lehtësojë gjithashtu takime të grave me origjinën e njejtë etnike, fetare, ose kulturore për të shkëmbyer përvojën për procesin zgjedhor dhe për t'u angazhuar në një proces jo-formal të rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e grave si qytetare politike.
2. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës mund të tërheqë vëmendjen ndaj fenomenit negativ të votimit familjar gjatë punës së saj të vazhdueshme për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në politikë dhe jetën publike.
3. Duke punuar në bashkëpunim me Asamblenë dhe Kongresin, Komiteti Drejtues për Barazinë midis Grave dhe Burrave (CDEG) mund t'i propozojë një rezolute Këshillit të Ministrave për të nxitur, zbatuar dhe mbështetur praktikën më të mira në zgjedhje dhe për zbatimin e ligjit elektorale në procesin demokratik elektorale në vendet anëtare.
4. Duke punuar në bashkëpunim me Asamblenë dhe CLRAE, CDEG mund të organizojë studime për praktikën më të mira dhe strategji të efektshme lidhur me programe për rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e grave si qytetare politike.

5. Komitetit i CLRAE për Kohezionin social mund të tërheqë vëmendjen e komiteteve të tjera statutore të Kongresit ndaj kësaj praktike dhe mund të hartojë me to një program të koordinuar veprimi për eliminimin e votimit familjar, duke përfshirë vëzhguesit zgjedhorë, organizatat që punojnë për forcimin e demokracisë dhe OJQ-të grave.
6. Nëpërmjet kanaleve të përshtatshme (si CLRAE), Këshilli i Evropës mund të mbështesë aktivitetet e OJQ-ve që punojnë për forcimin e demokracisë dhe organizatat e grave për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave si qytetare politike në nivel lokal, duke përfshirë të drejtën e tyre për votim.
7. Rëndësia e votimit familjar si një mohim i së drejtës së grave për votim dhe formë e manipulimit elektoral duhet të theksohet gjatë trajnimeve dhe informimeve të vëzhguesve zgjedhorë të realizuara nga Këshilli i Evropës.
8. Këshilli ndihmon në zbatimin e deklaratës së miratuar në Konferencën e 4-t Ministeriale Evropiane për Barazinë midis Grave dhe Burrave (Stamboll, 1997) dhe, veçanërisht, angazhimin për “përfshirjen e barazisë midis grave dhe burrave në monitorimin e përbushjes së detyrimeve demokratike nga vëndet anëtare.”
9. Shpërndarje e gjërë e raporteve të Këshillit të Evropës<sup>1</sup> për praktikën e mira dhe strategjitë për arritjen e përfaqësimit të barabartë të sekseve në vendimmarrjen politike. Kjo mund të shoqërohet me seminare për të drejtat politike të grave, të organizuara në bashkëpunim me OJQ-te lokale të grave dhe agjencitë, që punojnë për forcimin e demokracisë.
10. Të nxisin delegacionet kombëtare për t’a ngritur problemin e votimit familjar me komisionet e parlamenteve të tyre për të drejtat e grave si dhe me ministrat, që kanë përgjegjësi për ligjin elektoral dhe për të drejtat e grave.
11. Të vendosin problemin e votimit familjar në vëmendje të takimeve Evropiane për Shqyrtimin e Platformës së Kombeve të Bashkuara për Veprim të miratuar në Pekin.

#### *Vëndet anëtare*

Vëndet anëtare, nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore janë tashmë të angazhuara në respektimin e praktikave elektorale demokratike, duke

---

1. Shih *Arritja e Ekuilibrit midis Sekseve*, Botim i Këshillit të Evropës, 2002

përfshirë të drejta të barabarta për votim midis grave dhe burrave. Tani vëmendja e tyre duhet të fokusohet në zbatimin e vendimeve të mëposhtme.

1. Ligji elektoral duhet të përmbajë një dispozitë, në bazë të së cilës zyrtarët e komisioneve zgjedhore kanë përgjegjësi për çdo rast të neglizhencës në praktikën zgjedhore. Zyrtarët e komisioneve elektorale duhet të jenë të vetëdijshëm se ndaj tyre mund të merren masa të ashpra nëdshkimore në rast se në qendrat e votimit, për të cilat ata janë përgjegjës, zbulohen raste manipulimi. Masa të tilla do të zbatohen për rastet e votimit familjar ose për shkelje të tjera të ligjit elektoral.
2. Zyrtarët e komisioneve elektorale duhet të jenë plotësisht të trajnuar në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, ku theksi të vihet në rëndësinë e votimit individual dhe fshehtësinë e votimit, si dhe në nevojën e tolerancës zero për praktika që shkelin këto parime.
3. Zyrtarët elektoralë duhet të kenë ambiente dhe personel të përshtatshëm në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me praktikën më të mira demokratike.
4. Komisionet elektorale duhet të zbatojnë me rigorozitet procedurat demokratike.
5. Kur bëhet emërimi i komisioneve elektoralë duhet të tregohet kujdes për emërimin e zyrtarëve jo-vendas në zonat ku ka më shumë të ngjarë të ndodh votimi familjar (për shëmbull, zonat rurale).
6. Procedura e ankesave duhet të jenë lehtësisht të zbatueshme, të lehta për t'u kuptuar dhe të shpejta, si dhe duhet të përfshijnë një procedurë të efektshme hetimore.
7. Duhet të kryhen fushata publike informative para zgjedhjeve, duke theksuar rëndësinë e të drejtës individuale për votim dhe faktin se votimi familjar është një praktikë e papranueshme dhe e paligjshme. Fushata të tilla mund të jenë formën e edukimit të fokusuar në të drejtat e grave, por mund të jenë gjithashtu në formën e programeve të edukimit të gjërë të publikut për demokracinë, duke përdorur gratë në poste vendimmarrëse si shembuj për pjesëmarrje në procesin demokratik të vendimmarrjes.
8. Partitë politike duhet të zhvillojnë programe edukative për demokracinë, duke përfshirë module për barazinë midis seksëve me qëllim që të përmbushin kërkesat për financime nga shteti.

9. Grupet e grave në partitë politike duhet të inkurajohen dhe mbështeten për të trajtuar problemin e votimit familjar.

10. Në shkolla duhet të jepet arsimi për të drejtat e përgjithshme qytetare dhe barazinë, duke e vënë theksin në të drejtat e barabarta të grave me burrat në fushat politike, qytetare, shoqërore dhe ekonomike. Kur është e përshtatshme, këto programme duhet të trajtojnë traditat lokale si dhe praktikrat dhe mentalitetet, të cilat i detyrojnë gratë dhe vajzat të kenë një rol të dorës së dytë në shoqëri.

11. Arsimimi duhet të jetë një e drejtë bazë për të gjithë, ku gratë dhe vajzat, pavarësisht nga gjendja e tyre, duhet të kenë mundësi të barabartë për arsim të plotë.

12. Autoritetet lokale dhe rajonale duhet të rrisin ndërgjegjësimin për të drejtat e barabarta politike dhe qytetare të grave dhe të promovojnë praktikrat më të mira të votimit nëpërmjet medias elektronike, seminareve, dhe fushatave publike. Këto programe duhet të trajtojnë qëndrime dhe gjuhën diskriminuese mbi bazë seksi dhe të përdorin si model fushtatat e ndërgjegjësimit nëpërmjet medias të hartuara nga Grupi i Posaçëm për Gjinitë i Paktit të Stabilitetit.

13. Organizatat jo-qeveritare, që punojnë për konsolidimin e demokracisë, duhet të mbështeten dhe lehtësohen në punën e tyre nga autoritetet kombëtare, lokale dhe rajonale. Në veçanti, ato duhet të ndihmohen në edukimin dhe informimin e popullsisë lidhur me të drejtat individuale për votim.

14. Fletët e votimit duhet të plotësojnë nevojat e votuesve – për shëmbull, fletë votimi në dy gjuhë, të tregohen simbole të partive në fletët e votimit – për të ndihmuar votuesit analfabetë ose që nuk kanë patur mundësi të kenë informacion të mjaftueshëm për të marrë vendimet vetë, pa kërkuar ndihmën e të tjerëve.

15. Qeveritë kombëtare duhet të bëjnë një deklaratë politike ku të deklarojnë se gratë kanë të njëjtën të drejtë për votim si burrat dhe se ndalohej privimi të drejtës së grave për të hedhur votën e tyre.

16. Qeveritë kombëtare duhet të nxisin studimet për shkaqet dhe shtrirjen e votimit familjar, dhe, mbi bazën e konkluzioneve të tyre, të hartojnë programe kombëtare për eliminimin e praktikave të tilla, me afate kohore, objektiva dhe mekanizma monitorimi.

17. OJQ-të duhet të zhvillojnë veprimtari si grupe presioni që punojnë për barazi në procesin politik, duke e vënë theksin në veçanti në të drejtën e barabartë të grave për votim.
18. OJQ-të duhet të iniciojnë dhe/ose zhvillojnë aktivitete dhe programe trajnimi që synojnë të informojnë gratë për të drejtat e tyre civile dhe politike – programe të tilla si programi “Zhvillimi i të drejtave civile të grave” i Grupit të Posaçëm për Gjinitë i Paktit të Stabilitetit.
19. OJQ-të duhet të monitorojnë zgjedhjet në zonat e tyre për të vlerësuar shkallën e pjesmarrjes së grave në votim dhe t’i paraqesin një raport komisionit zgjedhor lidhur me mënyren e pjesmarrjes së grave dhe shkallën në të cilën gratë patën mundësi të hedhin votën e tyre lirisht.
20. OJQ-të e grave duhet të inkurajohen që të lidhen me OJQ-të që punojnë për zhvillimin e demokracisë, me qëllim që të grumbullohet përvoja, njohuritë dhe strategjitë e nevojshme për të mbështetur të drejtat individuale të grave për votim.
21. Autoritetet (kombëtare, rajonale dhe lokale) duhet të mbështesin shtrirjen e projekteve për rritjen e ndërgjegjësimit politik si fushata “Gratë mund t’ia dalin mbanë” dhe programeve për rritjen e rolit politik të grave të thjeshta, të hartuara nga Grupi i Posaçëm për Gjinitë i Paktit të Stabilitetit në fushat e vëndeve ku votimi familjar është problem.

### **Fuqizimi i grave si qytetare politike**

Ky studim i votimit familjar tregon qartë se gratë nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të ushtruar të drejtat e tyre politike. Kjo situatë është pasojë si e privimit të drejtpërdrejtë të të drejtave të tyre si votues gra ashtu dhe e mungesës së ndërgjegjësimit të vetë grave për të drejtat e tyre si qytetare politike. Në këtë pjesë janë përshkruar një numër praktikash inovatore të cilat ofrojnë mundësinë për të rritur njohuritë e grave për të drejtat e tyre si qytetare politike dhe për t’i mundësuar ato të shprehin preferencat e tyre demokratike në kutinë e votimit. Ato janë zgjedhur për të pasqyruar ekzistencën e alternativave të larmishme inovatore për të rritur ndërgjegjësimin politik të grave dhe për të rritur besimin për ushtrimin e të drejtave të tyre. Këto praktika nuk duhet të shihen si të vetmet të këtij lloji.

*“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” dhe Turqia: puna me gratë në zonat rurale*

Një nga problemet e punës mbi baza gjinore në shoqëritë ose grupet etnike që ruajnë praktika tradicionale është se gratë rrallë lejohen të takohen me “të huajt” pa praninë e meshkujve të tyre. Gjatë studimit të problemit të votimit familjar u pa qartë se kjo ishte një pengesë e madhe për aktivitetet në terren për rritjen e ndërgjegjësimit. Një aktivist që punonte për zhvillimin e çështjeve të të drejtave të njeriut në komunitetin shqiptar në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” përshkroi strategjinë që kishte përdorur për t’u takuar me gratë pa praninë e burrave. Ajo konstatoi se një çështje për të cilën burrat nuk dëshironin të ishin të pranishëm në një takim publik për të diskutuar ishte shëndeti i grave. Ajo e përdori këtë çështje si një mënyrë për të mbledhur gratë dhe pasi diskutoi problemet e shëndetit, grupi e përqëndroi vëmendjen e tij në çështje të politikave që kishin lidhje praktike me jetën e grave.

Kjo strategji ishte e ngjashme me atë të përdorur nga një aktiviste partie në një zonë rurale të Turqisë gjatë një fushatë zgjedhore në vitet 1990-të. Partia e re pro-fetare e Mirëqënies (e themeluar në vitin 1983) kërkonte të rriste mbështetjen e saj elektorale dhe kryetarja e një dege lokale të partisë shkoi në fshatin e saj të lindjes në Turqinë perëndimore, pranë qytetit të Bursës. Atje ajo i kërkoi një kushurire të saj të organizonte një takim me gratë në kohën kur burrat kishin shkuar në kafene. Në takim erdhën edhe gra nga fshatra fqinj dhe ajo e përdori takimin për të bërë fushatë për partinë e saj. Kur u numëruan votat Partia e Mirëqënies pati rezultate shumë të mira në fshatin dhe në zonen përreth, çka habiti shumë veta!<sup>1</sup>

Këto dy shembuj ilustrojnë se shpesh është e nevojshme të përdoret strategji me fantazi për të siguruar kontakte me gratë në zonat rurale, veçanërisht me ato që jetojnë në komunitete tradicionale. Efektshmëria e këtyre strategjive për të siguruar këto kontakte varet nga disa faktorë të rëndësishëm, më kryesori i të cilëve është besimi dhe mirëkuptimi për konfidencialitet midis anëtarëve të grupit si dhe midis grupit dhe aktivistit. Faktori tjetër është se aktivisti duhet të jetë një person, të cilin apo të cilën gratë e njohin apo kanë dëgjuar për të. Faktori i tretë që duhet të merret parasysh është se ky është vetëm hapi i parë për të vendosur kontakt me gra, të cilat për shkak të

---

1. Falenderimet për këtë informacion Profesor Jesim Arat, anëtar i Grupit të Specialisteve për Pjesëmarrjen e Ekuilibruar të Grave dhe Burrave në Vendimmarrjen Politike dhe Publike

zakoneve dhe praktikës jetesore bëjnë jetë shumë të izoluar. Kjo kërkon që aktivisti/OJQ-ja të hartojnë një plan, i cili u jep grave në mënyrë progresive mundësinë për të fituar të drejtat e tyre politike.

Megjithatë, kjo strategji, nëqoftëse do të shoqërohej me një fushatë publike për të drejtat e votuesve, e fokusuar tek gratë dhe burrat, mund të jetë një mjet i dobishëm për të edukuar gratë për të drejtat e tyre politike.

### *Bosnja dhe Hercegovina: “Gratë votuese mund t’ia dalin mbanë”*

Koncepti për ndërgjegjësimin e grave për rolin e tyre si votuese është i përhapur në kuadrin e Evropës Juglindore, dhe shumë vënde të këtij rajoni kanë hartuar një sërë strategjish mbi këtë temë. Projekti i Bosnjës dhe Hercegovinës është ambicioz. Ai synon të rrisë pjesmarrjen e votuesve gra të zonave rurale në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2002 në Bosnjë e Hercegovinë. Ai është planifikuar të zhvillohet nga Marsi në Dhjetor. Në vecanti, ai ka tre objektiva:

- të rrisë pjesmarrjen dhe të ulë numrin e votave të parregullta të grave në zonat rurale, duke verifikuar, njëkohësisht, regjistrimin e votuesve gra;
- të rrisë ndërgjegjësimin në zonat rurale për fshehtësinë e votës dhe të reduktojë problemin e votimit familjar;
- të rrisë shkallën e njohjes në zonat rurale për Ligjin e ri Elektorale në Bosnjë e Hercegovinë.

I hartuar nga Grupi i Posacëm për Gjinitë i Paktit të Stabilitetit, projekti trajton problemin serioz të mungesës së ndërgjegjësimit të grave në zonat rurale për procesin e votimit si dhe rolin e tyre të ri në zgjedhjet demokratike. Pra, ai trajton edhe problemin e ekzistencës së votimit familjar. Kjo nismë është ndërmarrë nga Grupi i Posacëm për Gjinitë dhe një koalicioni i OJQ-ve të grave të ndërgjegjësuara politikisht. Ajo synon të rrisë ndërgjegjësimin e grave në 40 komunitete lokale në Bosnjë e Hercegovinë. Punonjës në terren do të verifikojnë gjithashtu regjistrimin e votuesve gra në fshatra si dhe do të organizojnë takimet për rritjen e ndërgjegjësimin e votuesve në këto fshatra. Gratë do të informohen për Ligjin e ri Elektorale, dhe do t’u marrin informacion për vendndodhjen e qendrave të tyre të votimit dhe si plotësohen fletët e votimit. Ku është e mundur, në takime do të ftohen edhe anëtarët gra të këshillave komunale për të takuar votuesit gra. Përveç kësaj, gratë në zonat rurale do të kenë mundësi të takohen dhe shkëmbejnë mendime midis tyre. Ky projekt kërkon një shkallë të lartë koordinimi. Ai do të drejtohet nga një



bord kombëtar i projektit i përbërë nga 20 anëtarë. Qendra rajonale e Grupit të Posaçëm për Gjinitë në Zagreb do të kryejë kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të projektit. Grupi i Posaçëm për Gjinitë në Bosnjë e Hercegovinë do të kryejë zbatimin përmes partnerëve lokale, nën drejtimin e bordit të projektit.

Teknika “Gratë mund t’ia dalin mbanë”, e konceptuar në Norvegji, është një mjet trajnimi në shkallë të gjërë për gratë politike, por ajo mund të funksionojë gjithashtu si një teknikë për rritjen e ndërgjegjësimit para zgjedhjeve. Në bazë të përjasjes të kësaj teknike, organizohet perгатitja e disa trajnerëve ose aktivistë, dhe ata, nga ana e tyre, trajnojnë trajnerë dhe aktivistë të tjerë për të rritur ndërgjegjesimin për potencialin e grave në politike si dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre. Nje efekt i papritur anësor ka qënë se shumë nga trajnerët janë bërë vetë kandidatë politikanë. Shembulli i Kroacisë, që përshkruhet më poshtë, ilustron potencialin e kësaj strategjie.

*Kroacia: Nismat “Gratë mund t’ia dalin mbanë”*

Në vitin 1997 pesë gra Kroate përfunduan trajnimin për “Gratë mund t’ia dalin mbanë” në Budapest. Ato i sollën idetë e fituara në vendin e tyre dhe filluan të trajnonin gratë kroatë. Çdo vit, që atëhere, numri i trajnerëve të trajnuar dhe i takimeve lokale trajnuese është rritur, duke punuar me grupe të vogla grash në shumë lokalitete. Dy trajnerë organizojnë tre aktivitete trajnuese lokale në zonën e tyre. Para zgjedhjeve lokale të vitit 2001, afro 80 seanca trajnuese të veçanta njëditore u dhanë grave informacion bazë për barazinë gjinore dhe për nevojën e rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së grave në politikë. Shumë nga këto aktivitete trajnuese lokale u mbështetën nga politikanë meshkuj dhe kryetarë komunash.

Përveç trajnimit për “Gratë mund t’ia dalin mbanë” janë organizuar edhe shumë veprimtari të tjera. Grupe grash, si “BaBe” (“Aktivizohu, emancipohu”) dhe Qendra për Studime për Gra organizoi seminare dhe takime pune për të trajnuar gratë në teknika të diskutimit, daljes në publik, dhe shprehjes së mendimeve në publik. Këto aktivitete u mbështetën nga një fushtatë promovuese, e cila u bëri thirrje votuesve të votonin për gratë. Gjithashtu u shpërndanë qese plastike për të bërë pazar, stema, postera, fletushka si dhe u be reklamë televizive. Materialet u shpërndanë nëpërmjet një autobuzi në 23 qytete brënda 12 ditëve, i shoqëruar nga një bandë. Kjo ndihmoi të rritej vëmendja e medias. Këto përpjekje të koordinuara patën efekt: zgjedhjet

lokale dëshmuar rritjen e pranisë së grave në nivelin e këshillave nga 4 përqind në 20 përqind. Një pjesë e madhe e grave të zgjedhura ka marrë pjesë në seanca trajnuese të “Gratë mund t’ia dalin mbanë”.

Avantazhi i një programi si “Gratë mund t’ia dalin mbanë” është se u krijon mundësi grave të bëhen qytetarë politikane aktive – duke i inkurajuar ato të mbështesin kandidatë gra ose duke i pajisur ato me aftësi të nevojshme për të mbajtur poste përfaqësuese. Ai gjithashtu rrit besimin tek gratë se ato kanë të drejtë të barabartë si burrat për të marrë pjesë në jetën politike. Ky ndërgjegjësim ndihmon në rënien e praktikës së votimit familjar me kalimin e viteve. Ndërkohë mund të merren edhe masa të tjera për të inkurajuar gratë të bëhen të vetëdijshme për të drejtat e tyre politike dhe të drejtat e tjera.

#### *Republika Federale e Jugosllavisë: “Bëhuni të gjalla dhe aktive”*

Një sërë aktiviteteesh u organizuan për të rritur ndërgjegjësimin dhe, si rrjedhim, pjesëmarrjen e grave në zgjedhjet në shtator dhe dhjetor 2000. “Bëhuni të gjalla dhe aktive” (Goba) u fokusua tek gratë si një grup specifik dhe synonte t’i inkurajonte ato të shkëputeshin nga apatia politike. Ky program vazhdoi pesë muaj dhe u zbatua nga një koalicion i gjërë i grupeve të grave dhe OJQ-ve të tjera, të pavarura nga partitë politike. Aktivitetet kryesisht konsistonin në fushata publiciteti me postera, stampa, fletushka, stema, materiale promocionale si kapele, çanta, bluza, reklama ne radio, njoftime për shtyp, dhe një faqe internet. Pati gjithashtu veprime të drejtpërdrejta, të përqëndruara në qytete, plot me fantazi, te cilat tërhoqën një vëmendje të madhe të medias. Këto veprime përfshinin vendosjen e një shiriti përmes sheshit kryesor të Beogradit me parulla dhe fletushka nga të gjitha grupet e grave që mirrin pjesë në këtë program. Aktivitete dhe shfaqje u organizuan gjithashtu në qytete të tjera dhe fushata ishte e para që vendosi posterat e saj pas shpalljes së zgjedhjeve. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, pjesëmarrja e grave në zgjedhje u rrit duke u barazuar me atë të burrave.



## II. SHËMBUJ TË VOTIMIT FAMILJAR

Më poshtë janë paraqitur pjesë nga raportet për praktika të votimit familjar të vëzhguara nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (CLRAE), Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), Zyra e saj për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

### Shqipëria

*Zgjedhjet parlamentare, 24 qershor-19 gusht 2001  
OSCE/ODIHR*

Parimi i barazisë midis grave dhe burrave është sanksionuar në Nenin 18 të Kushtetutës së Shqipërisë: “të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” dhe “askush nuk mund të diskriminohet për arsye si seksi...”. Sipas një raporti për barazinë gjinore të hartuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD), legjislacioni shqiptar e parashikon konceptin e barazisë midis grave dhe burrave, por ende jo konceptin për shanse të barabarta. Sistemi nuk merr parasysh faktin se duhen marrë masa të posaçme për të siguruar shanse të barabarta për gratë. Ende nuk është marrë ndonjë veprim konkret pozitiv për të përsheptuar barazinë.

Megjithëse janë shumë aktive në nivelin lokal të jetës politike shqiptare dhe megjithëse disa parti politike u kanë garantuar grave një numër të caktuar postesh partiake, gratë përgjithësisht kanë vështirësi për t’u përzgjedhur si kandidatë dhe për të zënë poste kryesore në partitë politike. Vetëm 78 e 1,114 kandidatëve (7 përqind), të cilët morrën pjesë në zonat me votim të drejtpërdrejtë, dhe vetëm 120 e 823 kandidatëve (15 përqind) të listave proporcionale ishin gra. Numri i grave në vëndet e para të listave për të patur shans real për t’u zgjedhur, ishte edhe më i vogël. Gratë nuk përfaqësoheshin siç duhet edhe në strukturat administrative zgjedhore. Nuk kishte asnjë grua ndër anëtarët e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe vetëm 7 përqind e Komisioneve zonal zgjedhor (ZEC) dhe 8 përqind e komisioneve të qëndrave të votimit (VCC), të vizituara nga vëzhguesit më 24 qershor, ishin gra. Kodi zgjedhor nuk parashikon diskriminim pozitiv në favor të grave.

Megjithatë pothuajse të gjitha partitë dhe koalicionet politike përmbanin në programet e tyre politike referenca që reflektonin problemet gjinore dhe disa aktivitete elektorale drejtoheshin specifikisht te votuesit gra. Disa nga këto

aktivitete u pasqyruan në gazetatat kombëtare. Televizioni publik gjithashtu transmetoi programe të posacme për votuesit gra, ku morrën pjesë politikane të shquara.

Rezultati zgjedhor në zonat me votim të drejtpërdrejtë tregoi se vetëm shtatë gra fituan vënde në parlament. Nga listat proporcionale vetëm një grua arriti të fitonte një vënd në parlament. Prandaj, parlamenti i ri do të përfshijë tetë gra (5.71 përqind), në krahasim me 11 përqind në parlamentin e vitit 1997, i cili ishte pak më i madh. Ky përfaqësim nuk pasqyron forcën reale të gruas në shoqërinë shqiptare.

#### *Rekomandime – pjesmarrja e grave në procesin zgjedhor*

1. Partitë politike duhet të shqyrtojnë marrjen e masave për të inkurajuar një pjesmarrje më të madhe të grave në zgjedhje. Këto masa duhet të përfshijnë rritjen e transparencës në përzgjedhjen e kandidatëve, masa specifike për të rritur numrin e kandidatëve gra në vëndet e para në listat proporcionale, dhe rritjen e numrit të grave në komisionin qëndror dhe komisionet lokale.

2. Anëtarët i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve duhet të trajnohen për të mos lejuar votimin në grup. Programe të edukimit të votuesve duhet t'u shpjegojnë grave rëndësinë e marrjes së vendimit personal në hedhjen e votës së tyre.

#### *Zgjedhjet për pushtetin lokal, 1 dhe 15 nëntor 2000*

##### *OSCE/ODIHR*

Shumica e anëtarëve të komisioneve të qëndrave të votimit përgjithësisht i kryen detyrat e tyre mirë dhe në frymë bashkëpunimi, duke u krijuar kushte votuesve të votojnë lirisht gjatë gjithë ditës. Megjithatë, gjatë ditës së votimit doli në pah mungesa e trajnimit për anëtarët e këtyre komisioneve për faktin se komisionet u krijuan me vonesë. Kopjet e kodit zgjedhor dhe manualët e trajnimit u shpërndanë së bashku me materialet e votimit, dhe anëtarët e komisioneve të qëndrave të votimit nuk paten mundësi paraprake për të mesuar se si duhet të administrojnë qëndrat e votimit. Vëzhguesit raportuan se këto komisione shpesh nuk zbatuan sic duhet procedurat për shenjëzimin e votuesve me bojë dhe lejuan raste të shumta të votimit familjar, sipas traditës lokale.

*Raport për zgjedhjet e pushtetit lokal në Shqipëri, 1 dhe 15 tetor 2000  
CLRAE, CG/CP (7) 13 rev.*

*Raundi i pare*

46. Ditën e votimit u konstatuan çrregullimet e mëposhtme:

- Në shumicën e qendrave të votimit, që u vëzhguan, u konstatua “Votimi familjar” i cili ishte shkelje e parimit të votës së fshehtë. Kryetarët e komisioneve të qendrave të votimit shpesh nuk kishin dëshirë të ndërhyjnë në këto raste, duke përmendur “traditat kulturore”.

*Raundi i dyte*

73. Një çështje tjetër e përgjithshme shqetësuese për delegacionin e Kongresit ishin rastet e shpeshta të vëzhguara të “votimit familjar,” i cili ndodhte kur gruaja dhe burri, ose babai dhe fëmijët hynin së bashku në dhomën e fshehtë dhe plotësonin fletët e votimit së bashku. Kjo është natyrisht në kundërshtim me idenë e votës së fshehtë dhe, përveç kësaj, është një shkelje e të drejtës individuale të grave dhe të rinjve për votim.

74. Kur u pyetën për këtë, komisionet e qendrave të votimit shpesh nuk reagonin, sepse ata mendonin se kjo është një traditë kulturore ose e justifikonin duke thënë se shumë gra apo të rinj nuk dinin të lexonin apo të shkruanin. Ky justifikim duket se nuk ishte shumë i saktë sepse, përveç të tjerave, kjo gje duhej të ishte shënuar në procesverbalin e komisioneve të qendrave të votimit dhe një gjë e tillë nuk ishte bërë. Për këtë arsye, edukimi si i komisioneve ashtu dhe i votuesve për këtë çështje duhet t’i kushtohet rëndësi të veçantë.

*Referendumi për Kushtetutën (22 nëntor 1998)  
OSCE/ODIHR*

U konstatuan gjithashtu raste kur kryetarët e familjeve nënshkruanin për të gjithë familjen. Përveç kësaj, votimi familjar ose në grup është ende i përhapur dhe u konstatua në pothuaj 30 përqind të qendrave të votimit, që u vëzhguan. Pseudo-votimi dhe votimi i hapur ndodhi në rreth 2 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara.

*Raporti për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme lokale në Shqipëri (16 lokalitete) 21 qershor 1998 dhe (raundi i dytë) 28 qershor 1998  
CLRAE, CG/BUR (5) 61*

Shpesh, në një numër të madh të qëndrave të votimit, në dhomat e fshehta hynin njëkohësisht më tepër se një person: nganjëhere, shoqëronin të moshuar, nganjëhere çifte, ose baballarë dhe vajza. Edhe sikur të merret në konsideratë argumenti i “kultures”, duhet të merren masa për të ndryshuar gradualisht mentalitetin në mënyrë që çdo votuesi t’i garantohet me të vërtetë e drejta për votim të fshehtë individual.

*Zgjedhjet parlamentare, 29 qershor-6 korrik 1997  
OSCE/ODIHR*

Në zonat ku kishte vështirësi, shumica e problemeve konsistonin në fletë votimi të pavulosura apo të panënshkruara, votim familjar, ose raste kur kutitë e votimit nuk ishin të dyllosura siç duhet. Këto nuk mund të konsiderohen shkelje serioze. Vetëm në një përqindje të vogël të rasteve mund të flitet për probleme akute.

*Raporti informativ për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri (29 qershor-6 korrik 1997)  
Asambleja Parlamentare, Dok. 7902, Shtojca I, 8 shtator 1997*

109. Të rinjtë duhet veçanërisht të orientohen dhe nxiten për t’u nënshtruar programeve edukative dhe kulturore. Gratë në Shqipëri ballafaqohen me shumë probleme dhe mund të behen lehtësisht viktimë e llojeve të ndryshme të shfrytëzimit.

*Vëzhgimi i zgjedhjeve lokale në Shqipëri, 20 dhe 27 tetor 1996  
CLRAE, CG/BUR (3) 52 rev.*

41. Përgjithësisht u vunë re çrregullime të një natyre më pak serioze, të cilat nuk kishin ndonjë efekt të rëndësishme në rezultatet e votimit. Këto ishin raste ...kur bashkëshortët votonin së bashku... të cilat u konstatuan kryesisht në fshatra të vogla.

*Zgjedhjet parlamentare, 26 maj dhe 2 korrik 1996  
OSCE/ODIHR*

Disa ekiye raportuan raste kur njerëzit hidhnin në kuti disa fletë votimi dhe në shumë raste votimi familjar nuk ishte përjashtim, por një fenomen i përhapur.

Votimi familjar, deri në një farë shkallë, është fenomen që shfaqet në vende që nuk kanë tradita votimi. Nuk duhet lejuar në asnjë rrethanë që zyrtarët zgjedhorë t'i japin disa fletë votimi një votuesi të vetëm, siç u konstatua shpesh ditën e votimit.

## **Armenia**

*Zgjedhjet parlamentare, 30 maj 1999*

*OSCE/ODIHR*

Votimi familiar/kolektiv u raportua në 17 % të rasteve të vëzhguara.

*Raport Progresi nga Byroja e Asamblesë dhe Komiteti i Përhershëm – Raport informativ për zgjedhjet presidenciale në Armeni (16 dhe 30 mars 1998) Asambleja Parlamentare, Dok. 8058 Shtojca IV, 20 prill 1998*

21. Çrregullimet kryesore të vëzhguara ishin si më poshtë:

- u vu re dhe u dyshua se policë me uniformë dhe rroba civile ishin të pranishëm në qendrat e votimit dhe përpiqeshin të ndikonin në mënyrë jo të drejtëdrejtë tek votuesit, të cilët ishin të trëmbur nga prania e tyre;
- raste të panumrta të votimit “familjar” kolektiv, një praktikë e rëndomtë në periudhën sovjetike e trashëguar në ditët e sotme;...

*Raundi i dytë*

32. Çrregullimet e konstatuara ishin kryesisht në përsëritjen e gabimeve të mbartura nga raundi i parë. Përsëri pati raste të shumta të votimit familjar dhe, nganjëherë, rrëmujë në disa nga qendrat e votimit, çka bënte që kontrolli i kutive të votimit të mos ishte një punë e lehtë. Përveç kësaj, disa qendra votimi nuk ishin identifikuar siç duhet (mungesa e flamujve kombëtarë në hyrje), çka, në dukje, nuk kishte efekt tek popullsia lokale, e cila, siç duket, e dinte mirë vendodhjen e qendrave të votimit. Kryetari i cilësoi këto çrregullime si të vogla dhe tha se ato nuk mund të kishin ndonjë efekt në rezultatet e votimit.

*Zgjedhjet presidenciale, 22 shtator 1996*

*OSCE/ODIHR*

Vëzhguesve iu tha të ishin veçanërisht të vëmendshëm për shenja të votimit të shumëfishtë (votimi familjar) në qendrat e votimit. Megjithatë shumë vëzhgues cituan kryetarët e komisionet zgjedhore, sipas të cilëve kishte patur



raste kur disa votues ishin orvatur të votonin për anëtarë të tjerë të familjes, kjo gjë u konstatua në fakt në vetëm 3 % të qendrave të votimit. Shumë pak qendra votimi (2.6 %) i lejonin votuesit të votonin pa paraqitur ndonjë dokument identifikimi me fotografi.

## **Azerbajxhani**

*Zgjedhjet parlamentare, 5 nëntor 2000 dhe 7 janar 2001*  
*OSCE/ODIHR*

Vëzhguesit raportuan raste të shumta të votimit jashtë kutisë së votimit dhe nganjëherë anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe persona të tjera ndërhyjnë në vendimin privat të votuesve ose përpiqeshin të shihnin se si kishin votuar votuesit. Një numër praktikisht i lartë i raporteve (12.3 %) theksuan se disa votues u tregonin personave fletë votimi të shënuara paraprakisht përpara se t'i hidhnin në kutinë e votimit. Burrat shpesh votonin për bashkëshortet e tyre dhe nganjëherë për të gjithë familjen. Në raste të tjera, votuesit paraqisnin disa pasaporta dhe merrnin fletë të shumta votimi.

*Raporti për zgjedhjet lokale në Azerbajxhan të zhvilluara në 12 dhjetor 1999*  
*CLRAE, CG/Bur (6) 184*

U konstatuan [një] numër çrregullimesh:

- persona të pa-autorizuar ishin të pranishëm në qendrat e votimit dhe ndërhyjnë në punën e zyrtarëve zgjedhorë dhe votuesve;
- kishte mospërputhje midis firmave të paraqitura në listën e votimit dhe votave të numëruara në kutinë e votimit;
- fletë votimi të tepërta;
- përpjekje për të “mobilizuar” njerëzit që të votonin nga kryetarët e komisioneve zgjedhore, të cilët duket se mendonin se një veprim i tillë ishte i lavdërueshëm;
- përdorimi i pa-autorizuar i kutisë lëvizëse të votimit;
- menaxhimi i dobët i fletëve të papërdorura të votimit;
- veprimtaria e disa vëzhguesve lokalë u pengua;
- shtimi i votuesve të tjerë në listën zyrtare gjatë ditës së votimit;
- qendrat e votimit shpesh nuk u hapën në kohën e caktuar;
- brënda qendrave të votimit kishte propagandë zgjedhore;

- manipulime të fletëve të votimit gjatë votimit;
- vështirësi në procedurat e numërimit;
- votimi familjar;
- kuti votimi të pakontrolluara.

*Zgjedhjet parlamentare dhe referendumi kushtetues, 12 nëntor 1995*  
*OSCE/ODIHR*

Shumë kryetarë familjesh, vecanërisht në zonat rurale, mendonin se ishte e drejta e tyre të votonin edhe për bashkëshortet dhe fëmijët e tyre. Në fakt, votimi familjar është traditë në Azerbajxhan.

Megjithatë, kjo është një shkelje e ligjit elektoral dhe, në disa raste, njerëzit votonin edhe për fqinjët e tyre. Në një rast në jug të vendit, një vëzhgues pa një burrë që paraqiti 20 pasaporta dhe mori po aq fletë votimi. Përveç kësaj, votimi familjar nuk është vetëm një fenomen familjar; ai ka gjithashtu efekte të rëndësishme politike. Pranimi i votimit të shumëfishtë ditën e votimit nga zyrtaret ishte në kontrast të madh me respektimin rigoroz të ligjit gjatë fushatës nga autoritetet zgjedhore, të cilat refuzuan të pranonin nënshkrime në rastet kur një person kishte nënshkruar për disa anëtarë të familjes. Me një fjalë, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk pranoi votim të shumëfishtë duke përjashtuar kandidatë dhe parti që e kishin përdorur atë, ky votim u përdor me vonë për të plotësuar numrin e kërkuar të votuesve në mënyrë që zgjedhjet të ishin të vlefshme.

## **Bosnja dhe Hercegovina**

*Raport për zgjedhjet në Bosnje dhe Hercegovinë (11 nëntor 2000)*  
*CLRAE, CG/BUR (5) 54 rev.*

Delegacioni i CLRAE konstatoi disa të meta, duke përfshirë konfuzion në listat e votuesve, çka krijoi vështirësi për disa votues për të gjetur qëndrën e votimit ku duhej të votonin. Përdorimi i kutive të votimit nuk ishte një procedurë standarte: në disa qendra votimi e njëjta kuti votimi u përdor për lloje të ndryshme votimi, ndërsa në qendra të tjera kishte kuti të veçanta. Ashtu si në shumë vende të rajonit, burri dhe gruaja u panë shpesh të hynin në dhomën e fshehtë së bashku.

*Vëzhgime të zgjedhjeve në Bosnje dhe Herzegovinë (12 dhe 13 shtator 1998)  
Asambleja Parlamentare, Dok. 8216, 2 tetor 1998*

26. Përveç votimit familjar, i cili u konstatua kryesisht në zonat rurale, të gjithë vëzhguesit konstatuan probleme të shkaktuar nga mungesa e regjistrave zgjedhorë në shumë qendra votimi kur ato u hapën. Në disa qendra votimi filloi vetëm disa orë pas hapjes së tyre vonë në mëngjes ose pasdite, dhe në disa raste nuk u arrit të votohej në ditën e parë të votimit. Kjo është veçanërisht e dënueshme për faktin se këto ishin qendra votimi për refugjatët, të cilët kishin bërë përpjekje të konsiderueshme për të patur mundësi të votonin. Përveç kësaj, të njëjtat probleme ishin konstatuar në të njëjtat qendra votimi në zgjedhjet në vitet 1996 dhe 1997. Duhet theksuar gjithashtu se shumë njerëz nuk i kishin më emrat në rregjistrat zgjedhorë të zonave të tyre, megjithëse ata nuk i kishin ndryshuar adresat e tyre gjatë dy viteve të fundit. Disa njerëz pretendonin se megjithëse i kishin rregjistruar emrat e tyre disa herë ata ende nuk i kishin këto emra në lista dhe për disa njerëz të tjerë qendra e votimit, së cilës i përkisnin, kishte ndryshuar që nga zgjedhjet e mëparshme. Në disa qendra votimi kishte shumë votues në krahasim me disa qendra të tjera. Përveç kësaj, ODIHR i ndryshoi votuesit nga një qendër votimi në një tjetër në minutën e fundit, çka shkaktoi konfuzion të madh. U pretendua se kjo u shkaktua nga një problem kompjuteri. Kjo nuk krijoi përshtypje të mirë përse i përket efikasitetit të përgatitjes së zgjedhjeve.

*Vëzhgimi i zgjedhjeve rajonale dhe lokale në Bosnje dhe Herzegovinë  
(12 dhe 13 shtator 1998)  
CLRAE, CG/BUR (5) 54 rev.*

Pati një rënie të konsiderueshme të rasteve kur familjet hynin në dhomën e fshehtë së bashku.

*Zgjedhjet për Aseblenë Kombëtare në Republikën Serbe, 22 dhe 23 nëntor  
1997  
OSCE/ODIHR*

Afro 30 % e vëzhguesve konstatuan një apo më shumë raste të votimit familjar – më tepër se një person në dhomën e fshehtë në të njëjtën kohë – gjatë dy ditëve. Megjithëse problemi shkaktohej nga fakti se anëtarët e familjes dëshironin të votonin së bashku, ky problem nuk duhet neglizhuar duke e konsideruar thjesht si një “traditë lokale.” Një praktikë e tillë është

dekurajuar në vënde të tjera dhe, meqë edhe këtu ai kompromenton parimin e votës së fshehtë, ai nuk duhet lejuar në të ardhmen.

*Raport për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare në Republikën Serbe (Bosnja dhe Hercegovina) 22 dhe 23 nëntor 1999  
CLRAE, CG/BUR (4) 147*

Përshtypja e përgjithshme e anëtarëve të CLRAE është se një zgjedhje reflekton zakonet dhe traditat lokale.

Marrëdhëniet e ngrohta midis vëzhguesve dhe kontrollorëve, aspekti festiv i kësaj ngjarje qytetare dhe, mbi të gjitha, tradita e votimit si një familje ose një çift nuk duhen neglizhuar. Përsa i përket aspektit të fundit, anëtarët e delegacionit mendojnë se ai mund të ndodh për shkak të nivelit të analfabetizmit dhe mentalitetit të kryetarit të familjes. Por ata theksuan gjithashtu se kjo traditë nuk duhet konsideruar si votim familjar, i cili ndalohet nga Rregullat dhe Rregulloret.

*Raport informativ për zgjedhjet lokale në Bosnje dhe Hercegovinë (13 dhe 14 shtator 1997)  
Asambleja Parlamentare, Dok. 7902 Shtoca II, 22 shtator 1997*

22. Kushtet specifike në të cilat u zhvilluan zgjedhjet çuan në një procedurë votimi shumë komplekse, veçanërisht përse i përket votimit në mungesë dhe votimi nën kujdesin e të tjerëve. Duhet marrë masa të efektshme për të siguruar thjeshtëzim më të madh, për të rritur transparencën, për të bërë planifikim më të mirë dhe për të parashikuar vështirësitë përpara zhvillimit të zgjedhjeve të reja. Një shqetësim i ligjshëm ishte fshehtësia e votimit nën kujdes. Duhet përkufizuar gjithashtu më mirë rregullat për votimin familjar.

## **Bullgaria**

*Zgjedhjet parlamentare, 17 qershor 2001  
OSCE/ODIHR*

Votimi në grup dhe pseudo-votimi ishin në nivele shumë të ulta, përkatësisht 1.7 dhe 0.8 %. Vëzhguesit ndërkombëtarë konstatuan në katër raste, ose në 0.6 % të të gjithë vëzhgimeve, se votuesit nuk përdorën dhomën e fshehtë. Në shumicën e rasteve, votuesit me aftësi të kufizuar nuk u ndihmuan të votonin, gjë që është në kundërshtim me rregullat përkatëse.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Bullgari  
Asambleja Parlamentare, Dok. 9134, 25 qershor 2001*

Pavarësisht nga sistemi elektoral kompleks në Bullgari, në bazë të të cilit votuesit zgjedhin nga një numër fletë votimi me ngjyrë, të koduara, atë fletë që dëshirojnë të hedhin në kutinë e votimit, pati vetëm një numër relativisht të vogël fletë votimi të pavlefshme, gjë që tregon nivelin e edukimit të votuesve në Bullgari. Anëtarët e komisioneve vunë në dukje se partitë, të cilat përdornin emra të njëjtë me Lëvizjen e Koalicionit Kombëtar të Simeonit II, përdornin gjithashtu dizenjo me ngjyrë të njëjta në fletët e tyre të votimit, duke krijuar mundësinë për konfuzion tek votuesit. Vëzhguesit ndërkombëtarë konstatuan vetëm një numër shumë të vogël të votimit familjar, në grup, apo pseudo-votim.

## **Kroacia**

*Zgjedhjet për pushtet lokal, 20 maj 2001  
OSCE/ODIHR*

Votimi familjar/në grup u lejua në shumë zona. 13 % të raporteve përshtetë të paktën një rast të tillë, dhe 10 % të tjerë vunë në dukje se një fenomen i tillë kishte ndodhur dy deri në 20 herë. Është e qartë se kjo praktikë është e përhapur në shumë zona dhe komisionet e votimit bënin pak ose asnjë përpjekje për të parandaluar atë.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Kroaci (3 janar 2000)  
Asambleja Parlamentare, Dok. 8624, 24 janar 2000*

12. Një numër vëzhguesish vunë në pah problemin e votës së fshehtë dhe votës së pakicave. Ata theksuan se nganjëherë nuk kishte dhomë të fshehtë ose zarfa. Nuk mund të thuhet se votimi ishte i fshehtë, pasi fletët e votimit kishin ngjyra të ndryshme dhe për minoritetet listat e votuesve ishin të veçanta. Në disa raste u konstatua votim familjar. Në rajone të ndjeshme u raportuan incidente serioze, megjithëse të izoluara. Ato përfshinin frikësimin

e votuesve, përlshje përpara qëndrave të vitimit, ose, në raste të rralla, prani e policisë brënda qëndrës së votimit.

## **Estonia**

*Zgjedhjet parlamentare, 7 mars 1999*  
*OSCE/ODIHR*

Raste të votimit në grup u përmendën nga 28 % e vëzhguesve dhe 9 % të tjerë thanë se kishin konstatuar raste të votimit të hapur (për shëmbull, jo në dhomën e fshehtë).

## **Gjeorgjia**

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale në Gjeorgji (9 prill 2000)*  
*Asambleja Parlamentare, Dok. 8742, 16 maj 2000*

Anëtarët e komisioneve raportuan dhe ishin dëshmitarë të disa rasteve të shkeljeve dhe parregullsive të procesit zgjedhor. Votimi familjar ishte shqetësimi ynë më i vogël.

*Zgjedhjet parlamentare, 31 tetor dhe 14 nëntor 1999*  
*OSCE/ODIHR*

Raste të votimit “në grup” ose “familjar” u raportuan nga 21 përqind e vëzhguesve.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Gjeorgji (31 tetor 1999)*  
*Asambleja Parlamentare, Dok. 8605, 22 dhjetor 1999*

23. Në disa zona votimi familjar ishte një nga shkeljet më të përhapura të Ligjit Zgjedhor. Në disa qendra votimi vëzhguesit panë anëtarët e familjeve të hynin në dhomën e fshehtë bashkë ose një anëtar të familjes duke votuar për një anëtar tjetër. Në disa raste, zyrtarët e qendrat e votimit e lejonin një gjë të tillë, duke marrë parasysh moshën e votuesit dhe vështirësitë fizike për të votuar. Kjo shkelje mund të shpjegohet me faktin se në periudhën sovjetike njerëzit lejoheshin të votonin për anëtarët e familjes së tyre, të cilët ishin semurë ose nuk ishin të pranishëm në kohën e zgjedhjeve.

Duhet theksuar se disa vëzhgues nuk panë raste të kësaj praktike dhe se shume zyrtarë të qëndrave të votimit dhe vëzhgues lokale ishin mjaft vigjilent në këtë drejtim.

## **Hungaria**

*Zgjedhjet parlamentare, 10 dhe 24 maj 1998*

*OSCE/ODIHR*

Siç u theksua më sipër, procesi i përgjithshëm i votimit u administrua në një mënyrë shumë profesionale. Megjithatë, pati tre aspekte të procesit, dy prej të cilave pasqyrohen në tabelën e mëposhtme, të cilat duhen komentuar

	<b>% totali i raundit të parë</b>	<b>% totali i raundit të dytë</b>
Votimi në grup	16.00 %	17.60%
Votimi i hapur	15.00 %	9.87%

Votimi në grup: njerëzit futen në dhomën e fshehtë së bashku

Votimi i hapur: njerëzit plotësojnë fletët e votimit hapur, jo në dhomën e fshehtë

Të dyja këto raste duhen sqaruar. Përsa i përket votimit në grup, vëzhguesit asnjëherë nuk konstatuan se votuesit ishin nën ndonjë lloj presioni. Në shumicën e rasteve ishte e qartë se votuesit ndjeheshin rehat së bashku, shpesh ata ishin burri dhe gruaja, ose miq të moshuar. Në disa raste, ishte e qartë se një person në fakt kërkonte ndihmë, por e kishte patur të vështirë t'ia kërkonte këtë ndihmë Komisionit të Qendrës së Votimit. U vu në dukje së kjo praktikë është më e përhapur në zonat rurale. Megjithatë, një praktikë e tillë është qartësisht një shkelje e Ligjit Zgjedhor dhe e votës së fshehtë individuale.

Votimi i hapur, nga ana tjetër, nuk është shkelje ligjore në Hungari. Neni 68.1 i Aktit 100 (1997) thote: “Votuesit nuk janë të detyruar të përdorin dhomat e fshehta.”

*Zgjedhjet lokale në Hungari, 30 shtator 1990*

*CLRAE, CPL/P (25) 18*

Delegacioni i CLRAE vuri re një numër të metash të vogla, si, për shëmbull, çifte dhe nganjëherë familje të tëra votuan bashkë në dhomën e fshehtë, jashtë dhomës së fshehtë, si dhe raste kur kishte shumë njerëz në qëndrat e votimit.

## **Letonia**

*Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare në Letoni (3 tetor 1998)*  
*Asambleja Parlamentare, Dok. 825, 3 nëntor 1998*

41. Vëzhguesit tanë vunë re shumë pak parregullsi. Ndoshta duhet përmëndur se shumë votues nuk hynë në dhomat e fshehta. Megjithatë, duhet theksuar se në disa qendra votimi, ku pjesmarrja e votimit ishte më e madhe se sa pritej, nuk kishte dhoma të fshehta në mënyrë të mjaftueshme. Kjo ndodhi sepse ishte e vështirë të parashikohej pjesmarrja, sepse votuesit ishin të lirë të votonin në secilën nga qendrat e votimit në vend. Pati gjithashtu disa raste të “votimit familjar”.

*Raporti i Këshillit të Evropës (CLRAE)*  
*Delegacioni i vëzhguesve në zgjedhjet lokale (dhe rajonale) në Letoni, 29 maj 1994*  
*CLRAE, CG/BUR (1) 13*

Në shumicën e qendrave të votimit në Riga doli se dhomat e fshehta ishin të vogla për shkak të madhësisë shumë të madhe të fletës së votimit. Gjatë orëve të kulmit të pjesmarrjes votuesit i plotësuan fletët e tyre të votimit në tavolina jashtë dhomave të fshehta. Kjo u tolerua gjithmonë nga kryetarët e komisioneve zgjedhore, sic ishte edhe rasti i familjeve që hynin së bashku në dhomën e fshehtë.

## **Lituania**

*Zgjedhjet parlamentare, 20 tetor dhe 11 nëntor 1996*  
*OSCE/ODIHR*

Plotësimi i fletëve të votimit në dhomat e fshehta nga disa votues në të njëjtën kohë, zakonisht anëtarë të së njëjtës familje, është një devijim tjetër i rëndomtë nga Neni 65, pjesa 1 e Ligjit Zgjedhor. Kjo u vu re në 102 qendra votimi.

Megjithatë, për këtë rast, Ligji aktual Zgjedhor nuk është i qartë. Në pjesën 6 të Nenit 65, përkthimi zyrtar në gjuhën angleze thotë: “Votuesi, i cili për shkak të paaftësisë fizike nuk është në gjëndje të plotësojë fletën e votimit vetë dhe t’u hedhë atë në kutinë e votimit, mund t’i kërkojë një personi tjetër (me përjashtim të kryetarit të komisionit apo anëtarëve të tij, ose një vëzhguesi të zgjedhjeve) t’i bëjë këto veprime në vënd të tij.”



Teksti origjinal në Lituanisht përdor një term më të gjërë se “paaftësi fizike”, një term që është më afër “dëmtimit fizik”. Përveç kësaj, nuk ka dispozita në bazë të cilave komisioni zgjedhor do t’i kërkonte votuesit provë për “dëmtimin fizik”, apo të kishte të drejtë t’i jepte leje këtij votuesi të hynte në dhomën e fshehtë të shoqëruar nga një person tjetër. Si rezultat i kësaj, komisionet zgjedhore nuk dëshironin të ndërhynin sepse i trëmbeshin një përplasje me votuesit.

Ky përkufizim i mjegullt dhe i jo i plotë i “dëmtimit fizik” për votimin në qendrat e votimit është në kontrast të madh me dispozitat e hollësishtme për votimin në shtëpi si pjesë e votimit me korrespondencë i trajtuar nga Neni 66, pjesa 7, e cila kërkon vërtetim me shkrim për paaftësinë nga kujdestari social i bashkisë apo rajonit dhe institucionet e kujdesit për t’a lejuar votuesin të votojë në shtëpi.

## **Moldavia**

*Raport i delegacionit të CLRAE për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Taraclia Judet (Moldavi) në 23 janar 2000*  
*CLRAE, CG/BUR (6) 131 konfidencial*

Megjithatë, delegacioni i vëzhguesve të CLARE vuri re një numër parregullsish, të cilat ishin si më poshtë:

- votimi familjar;
- interpretime kontradiktore të rregullave zgjedhore në disa qendra votimi;
- mungesa e letrave të votimit në gjuhën Moldave në disa qendra votimi ku ishin rregjistruar votues që flisnin Moldavisht;
- votimi pa dokument identifikimi nga disa të moshuar, të cilët, ishin të njohur nga anëtarët e komisioneve zgjedhore;
- ndërhyrje e vëzhguesve vendas në punën e komisioneve të qendrave të votimit dhe tek votuesit në disa qendra votimi;
- pankarta agjitacioni në mure në disa vende ditën e votimit.

Duhet theksuar se parregullsi të tilla, si votimi familjar, apo pajisja me fletë votimi e disa njerëzve pa dokumenta identifikimi por që njiheshin nga anëtarët e komisionve zgjedhore ndodhën për shkak të traditave kulturore lokale, dhe nuk kishin synim të ushtronin ndikim ndaj votës. Pati gjithashtu

një numër të madh njerëzish të rregjistruar në listat shitesë, gjë që ishte kryesisht rezultat i shkallës së lartë të lëvizjes së popullsisë, veçanërisht të të rinjve.

*Raporti i misionit të delegacionit CLRAE në Republikën e Moldavisë për të monitoruar zgjedhjet lokale dhe rajonale në 23 maj 1999  
CLRAE, CG/BUR (6) 16*

Dhomat e fshehta u përdorën nga më tepër se një person në të njëjtën kohë, veçanërisht në zonat rurale.

*Zgjedhjet parlamentare, 22 mars 1998  
OSCE/ODIHR*

Votimi familjar është ende një praktikë e zakonshme, veçanërisht në fshatra. Në total, votimi familjar u konstatua në më tepër se 30 % të qendrave të votimit të vëzhguara, ndërsa votimi i hapur në 5.5 % të tyre. Rregullat për të ndihmuar votuesit që kishin nevojë për ndihmë u shkelën në një numër të madh të rasteve të vëzhguara.

*Raporti për progresin nga Byroja e Asamblesë dhe Komiteti i Përhershëm –  
Raporti informativ për zgjedhjet parlamentare në Moldavi (Chisinau,  
19-24 mars 1998)  
Asembleja Parlamentare, Dok. 8058, Shtojca II*

Megjithëse komiteti *ad hoc* konstatoi se zgjedhjet ishin organizuar në një mënyrë profesionale, ai identifikoi disa fusha ku mund të bëhen përmirësime, si:

- forma e fletëve të votimit;
- procedura për vulosjen e fletëve të votimit;
- aftësia e zyrtarëve të qendrave të votimit për të përcaktuar kur një fletë votimi ishte e vlefshme dhe ku nuk ishte e vlefshme;
- trajnimi i vëzhguesve në qendrat e votimit;
- prania e njerëzve të paautorizuar në numërimin e votave;
- praktika e votimit familjar.

*Zgjedhjet presidenciale, 17 nëntor dhe 1 dhjetor 1996*  
*OSCE/ODIHR*

Në raundin e dytë afro 40 % e raporteve të vëzhguesve përshkruan raste të votimit familjar. Kjo ishte një shifër e lartë pavarësisht nga përpjekjet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) për të udhëzuar komisionet e qëndrave të votimit për të pakësuar votimin familjar.

*Raport i një delegacioni i CLRAE për monitorimin e zgjedhjeve të para lokale në Republikën e Moldavisë të zhvilluara më 16 prill 1995*  
*CLRAE, CG/CP (2) 8*

Nga ana tjetër, dobësitë më të dukshme ishin: “praktika e përhapur e banorëve për të hyrë në dhomën e fshehtë në grup (votimi familjar)”.

*Vëzhgimi i referendumit të Moldavisë për statusin e Gagauzisë*  
*CLRAE, CG/CP (1) 48, 21 mars 1995*

67. Parregullsia më e dukshme ishte ndoshta zakoni i “votimit familjar.” Një praktikë e krijuar në periudhën sovjetike, votimi familjar ishte rasti kur një anëtar i familjes, zakonisht babai, paraqiste pasaportën e gruas së tij dhe nganjëherë të anëtarëve të tjerë të familjes dhe votonte për ta. Kjo praktikë ndalohet shprehimisht nga pika 22 e Rregullores së Përkohshme – një dispozitë, e cila, sipas mendimit të kryetarit të një komisioni zgjedhor të një qyteti, ishte futur apostafat për t’a bërë referendumin për çështjen e Gagauzisë më të vështirë.

68. Vëzhguesit konstatuan se megjithëse komisionet zgjedhore, me përjashtime të pakta, kundërshtuan zakonet e votimit familjar, në disa qendra votimi ky votim u tolerua. Në shumë raste vëzhguesit panë se si një familje paraqitej para komisionit zgjedhor, tregonte pasaportat e veta, çdo anëtar i familjes mirrte fletën e tij apo të saj të votimit dhe pastaj babai nënshkruante në listën e votuesve për të gjithë anëtarët e familjes. Megjithatë, votat hidheshin individualisht nga çdo anëtar i familjes. Në një qëndër votimi një kontroll i rastësishëm i nënshkrimeve tregoi se nënshkrimi në emër të familjes mund të kishte ndodhur në afro 3 deri në 5 % të të gjithë nënshkrimeve.

## **Polonia**

*Zgjedhjet lokale në Poloni në 27 maj 1990*  
*CLRAE, CPL/P (25) 9*

U konstatuan disa detaje teknike: mungesa e llogaritjes së numrit të fletëve të votimit që ishin hedhur në kutitë e votimit, përdorimi i dhomës së fshehtë nga e gjithë familja në të njëjtën kohë dhe fakti se disa votues nuk përdorën dhomat e fshehta për të plotësuar fletët e tyre të votimit.

## **Rumania**

*Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, 26 nëntor 2000*  
*OSCE/ODIHR*

Votimi familjar ndodhi në 28 % të rasteve dhe ishte një fenomen më i përhapur në zonat jashtë Bukureshtit – 47 % në zonat rurale dhe 18 % në zonat urbane. Kur një burrë dhe një grua hynin së bashku në dhomën e fshehtë, kjo jo vetëm kompromentonte fshehtësinë e votës por një bashkëshort(e) mund të ndikonte gjithashtu në votën e bashkëshortit të saj apo bashkëshortes së tij.

## **Federata Ruse**

*Zgjedhjet presidenciale, 26 mars 2000*  
*OSCE/ODIHR*

Votimi familjar, apo votimi së bashku në grupe, u konstatua në 82 % të qendrave të votimit. Megjithatë, vëzhguesit e vlerësuan këtë shkelje si “të parëndësishme” për faktin se në qendrat e votimit ishin vendosur dhoma të fshehta dhe se vetë votuesit nuk dukeshin të shqetësuar për fshehtësinë e votës së tyre. Pseudo-votimi apo votimi në emër të një personi që nuk ishte i pranishëm në qendrën e votimit u konstatua në 34 % të qendrave të votimit të vëzhguara. Vëzhguesit i vlerësuan përsëri këto raste si “të parëndësishme” duke u nisur nga shpeshësia e tyre në qendrat që ata vizituan.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve presidenciale në Rusi (16 mars 2000)*  
*Asambleja Parlamentare, Dok. 8693, 3 prill 2000*

Votimi familjar ishte një praktikë e zakonshme.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Federatën Ruse  
19 dhjetor 1999*

*Asambleja Parlamentare, Dok. 8623, 24 janar 2000*

45. Megjithatë, në 100 qendra votimi të përzgjedhura rastësisht, të cilat anëtarët e komitetit ad hoc i vizituan gjatë ditës së votimit, ata konstantuan një numër parregullsish, të cilave kërkojnë vëmendjen e duhur nga ana e autoriteteve:

- pajisja e qendrave të votimit: shumë prej tyre ishin shumë të vogla dhe numri i dhomave të fshehta ishte shpesh i pamjaftueshëm, çka i privonte votuesit nga mundësia për të plotësuar fletët e votimit në mënyrë të fshehtë;
- votimi familjar;
- shenjat e partive dhe kandidatëve: ende lejoheshin që të vendoseshin brenda qendrave të votimit, ku mund të vëzhgoheshin;
- në qendra votimi ishin vendosur postera që përmbanin informacion për pasuritë, pronat dhe të ardhurat e kandidatëve; ky informacion duhet të jetë privat, dhe duhet të shpallet dhe rregjistrohet vetëm në rastin e zgjedhjeve;
- kutitë e lëvizshme: disa prej tyre ishin të pavulosura, veçanërisht në Rostov. Përveç kësaj, procesi i votimit me kuti të lëvizshme është shumë i gjatë, veçanërisht për shkak të kompleksitetit të fletëve të votimit dhe numrit të zgjedhjeve që zhvilloheshin në të njëjtën kohë (katër zgjedhje të ndryshme, për shëmbull, në Moskë).

*Zgjedhjet presidenciale, 16 qershor dhe 3 korrik 1996*

*OSCE/ODIHR*

Kritika më thelbësore u bë për mungesën e votimit të fshehtë si dhe lidhur me problemin e “votimit familjar” – rastit kur një person, zakonisht burri, votonte për një person tjetër, zakonisht bashkëshortja, ose votimi i hapur familjar në grup. Në Federatën Ruse ende nuk është kuptuar qartë rëndësia e marrjes së masave për ruajtjen e fshehtësisë së votës dhe autoritetet e konsiderojnë të mjaftueshëm faktin që votuesve u ofrohet mundësia për të votuar apo jo në fshehtësi. Vëzhguesit tërhoqën vëmendjen ndaj shumë rasteve të të dy këtyre praktikave dhe i kërkuan Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të udhëzojë komisionet lokale për marrjen e masave për të siguruar votim të fshehtë dhe individual. Në një numër qendrash votimi, votuesit u nxitën aktivisht të

votonin jashtë dhomave të fshehta duke vendosur tavolina dhe stilolapsa jashtë këtyre dhomave.

## **Republika Sllovake**

*Zgjedhjet parlamentare, 25 dhe 26 shtator 1998  
OSCE/ODIHR*

Votimi familjar apo në grup, domethënë prania e më tepër se një personi në dhomën e fshehtë në të njëjtën kohë, u konstatua në pothuajse 20 % të qendrave të votimit. Kjo nuk është në përputhje me ligjin dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Brëndshme që u habitën kur dëgjuan për këtë shifër relativisht të lartë pas zgjedhjeve. U tha se ky problem do të trajtohej me trajnimin e anëtarëve të komisionve të qendrave të votimit për zgjedhjet lokale në nëntor.

*Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare në Sllovaki (25 dhe 26 shtator 1998)  
Asambleja Parlamentare, Dok. 8254, 3 nëntor 1998*

32. Pati, natyrisht, disa parregullsi, si votimi familjar dhe mungesa e qartësisë në rregullat që kanë të bëjnë me metodat për vulosjen e kutive të votimit. Megjithatë, duke patur parasysh mënyrën e përgjithshme si u zhvilluan zgjedhjet, këto parregullsi u konsideruan të parëndisishme dhe se ato patën një efekt të vogël në rezultatet e votimit.

## **“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”**

*Raporti i misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në “ish Republikën  
Yugosllave të Maqedonisë”, 10 dhe 24 shtator 2000  
CLRAE, CG/CP (7) 12 rev.*

Në disa zona të vëndit, delegacioni i Kongresit konstatoi shumë raste kur kryetarët e familjeve votuan në emër të të gjithë anëtarëve të familjes, si gruas dhe fëmijve. Kjo është qartë një shkelje e të drejtave individuale për votim. Delegacioni i dënoi parregullsitë e shumta lidhur me votimin e shumëfishtë, në të cilin, në disa qendra votimi, u implikuan edhe zyrtarë të komisioneve zgjedhore. Ky konstatim u konfirmua në raundin e dytë të votimit.

Megjithëse kjo praktikë mund të jetë e kuptueshme në raste të caktuara, si, për shëmbull, në rastin e votuesve të verbër apo me paaftësi të tjera, delegacioni nuk mund të pranojë që një person të vendosë për votën e të gjithë familjes. Disa ekupe vëzhguesish panë gjithashtu raste të mbushjes së kutive të votimit, kur një person vinte me disa fletë votimi dhe i hidhte ato të gjitha në kutinë e

votimit. Në po këto qendra votimi delegacioni konstatoi pjesmarrje rekord në votim (afro 95 përqind) dhe një rezultat pothuajse plebishtar për një nga kandidatët.

*Zgjedhjet presidenciale, 31 tetor dhe 14 nëntor 1999*  
*OSCE/ODIHR*

#### *Raundi 1*

Ashtu si në vitin 1998, problemet më të rëndësishme që konstatuan vëzhguesit ishin pseudo-votimi në 9.41 % të qendrave të votimit të vëzhguara dhe votimi grup në 14.9 % të këtyre qendrave. Vëzhguesit panë raste kur një person vinte me disa fletë votimi në duar ose kur një kuti votimi përmbante disa fletë votimi të palosura së bashku, çka tregonte qartë se ato ishin hedhur bashkë si tufë në kuti.

Në shumë raste të pseudo-votimit në zonat e banuara nga Shqiptarë etnike, kryetari mashkull i familjes votoi për anëtarët femra të familjes. Në disa raste, gratë ishin të pranishëm. U pretendua përsëri se kjo ishte “një zakon normal lokal.” Megjithatë, këto praktika janë të papranueshme sepse i privon gratë nga e drejta për të votuar si dhe bën që sistemi të jetë i hapur për abuzime në shkallë të gjërë.

#### *Raundi 2*

Problemi më i rëndësishëm që u konstatua ishte përsëri rasti kur votuesit nuk paraqisnin kartën e votuesit dhe dokumenta identifikimi, si dhe rastet e pseudo-votimit dhe votimit familjar. Shumica e raporteve negative të vëzhguesve kishin të bënin për rastet e shumta të pseudo-votimit dhe votimit familjar. Këto raporte negative ishin kryesisht për zonat e banuara nga Shqiptarët etnikë si Lipkov (21), Cegranë (52), Kamenjanë (55), Aracinovë (64) dhe Studenican (66). Rezultat finale nga këto zona ishin gjithashtu shumë shqetësuese.

Një raport vëzhguesish nga Studenican-i bëri një përshkrim tipik të problemeve të hasura në këto zona. Kryetari i degës lokale të Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) vizitoi qendrat e votimit në zonën e tij ditën e votimit, dhe u bëri thirrje njerëzve të votonin për kandidatin e [partisë politike] VMRO. Në qendrën e votimit 66/2353, kryetari i PDSH-së u zu me krytarin e komisionit të qëndrës së votimit, duke e vënë fajin mbi të për pjesmarrjen e ulët të votuesve në votim, e cila ishte rreth 20 % në orën katër pasdite. Më vonë, katër anëtarë të VMRO hynë në këtë qendër votimi dhe

qëndruan atje për të “kontrolluar votimin.” Pas largimit të vëzhguesve në qëndër hynë një numër i madh votuesish. Raste të përhapura dhe të përsëritura të votimit familjar dhe pseudo-votimit u konstatuan edhe në qendra të tjera të votimit në zonë. Përfaqësuesit e partive politike në komisionet e qëndrave të votimit nganjëherë dukeshin të pasigurtë se cilën parti përfaqësonin.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” (31 tetor dhe 14 nëntor 1999)  
Asambleja Parlamentare, Dok. 8604, 22 dhjetor 2000*

Votimi familjar ishte më pak i përhapur se në vitin 1998. Në përgjithësi në qëndrat e votimit nuk u vu re tension.

36. Megjithatë, për përmisimin e mëtejshëm të proceseve të ardhshme zgjedhore, komiteti *ad hoc* u bëri thirrje autoriteteve maqedonase:

- të merrnin masa për të parandaluar mosmarrëveshje lidhur me emërimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe për t’ia përshtatur modalitetet e emërimit të anëtarëve të komisioneve elektorale rajonale dhe të qëndrave të votimit gjëndjes reale politike në momentin e zgjedhjeve;
- të përgatisnin ligje më të hollësishme për mbulimin e zgjedhjeve nga media dhe për t’u dhënë status ligjor udhëzimeve të nxjerra nga Këshilli i Transmetimeve;
- të vazhdonin dhe përmisnin informacionin e votuesve për procedurat e votimit, duke e vënë theksin në votimin familjar si shkelje të këtyre procedurave;
- të analizojnë me kujdes të gjitha parregullsitë e raportuara dhe të bëjnë publike këto analiza.

*Zgjedhjet parlamentare, 18 tetor dhe 1 nëntor 1998  
OSCE/ODIHR*

#### *Raundi 1*

Raste të votimit në grup u raportuan në 382 nga 1,314 reportet (29.07 %). 78 nga 1,314 (5.92 %) prej tyre raportuan raste të votimit fallco. 1000 nga 1,314 (8.85 %) raportuan raste të votimit të hapur. Shqetësimi kryesor i vëzhguesve kishte të bënte me praktikën e pseudo-votimit, votimit të hapur, dhe veçanërisht, votimit në grup. Në takimin raportues vëzhguesit theksuan se praktika e votimit në grup është veçanërisht shqetësuese dhe përbën një problem të veçantë për votuesit femra.



Vëzhguesit raportuan se në disa raste, veçanërisht në zonat rurale në perëndim të vendit, kryetari mashkull i familjes shpesh votonte për anëtarët femra, të cilat ishin të pranishme por nuk morren pjesë aktivisht në proces. Disa vëzhgues raportuan se pseudo-votimi shpesh kryhej nga kryetari mashkull i familjes pa praninë e anëtareve femra.

### *Raundi 2*

Vëzhguesit ishin përsëri shumë të shqetësuar për numrin e madh të rasteve të votimit në grup, veçanërisht për faktin se kjo praktikë i hap derën një sërë praktikash të ngjashme të paligjshme, duke përfshirë pseudo-votimin dhe privimin e plotë të shumë votuesve femra nga e drejta për të votuar.

Pseudo-votimi u raportua veçanërisht në Zonën 66, kur disa persona u panë duke hedhur disa fletë votimi në kutitë e votimit, dhe jo “vetëm” për anëtarët femra të familjes. U panë gjithashtu persona, të cilët grumbullonin fletë votimi të personave që nuk i kishin përdorur ato ende gjatë ditës, i sillnin ato në qendrat e votimit dhe votonin me to.

*Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” (15-19 tetor 1998)*

*Zgjedhjet parlamentare, Dok. 8257, 3 nëntor 1998*

Megjithatë, vëzhguesit vunë re disa parregullsi, veçanërisht lidhur me praktikën e përhapur të votimit familjar, veçanërisht në perëndim të vendit, ku dominon pakica shqiptare. Në disa zona në rajonet e Tetovës dhe Gostivarit, afro 80 deri në 90 % të grave nuk votuan personalisht. Votat e tyre u hodhën në kutitë e votimit nga burri, babai, apo vëllai.

Duke lënë mënjanë shpjegimet e mundshme kulturore, duhet theksuar gjithashtu se fletët e votimit ishin shkruar vetëm në Maqedonisht (me shkrimin Cirilik), gjuhë që nuk flitet apo lexohet nga shumë shqiptarë maqedonas. Shume gra janë analfabete dhe flasin vetëm shqip. Prandaj, ishte e pamundur për to të ushtronin siç duhet të drejtat e tyre për votim.

*Raporti i misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale që u zhvilluan më 17 nëntor 1996 në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”*

*CLRAE, CG/BUR (3) 62*

Të gjithë anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit e dinin se si duhej të vepronin dhe delegacioni nuk vuri re ndonjë konfuzion. Siç u përmënd edhe më sipër, dhomat e fshehta ishin shumë të vogla, dhe numri i tyre nuk ishte i

mjaftueshëm, veçanërisht në qendrat e votimit në Shkup. Në orët kur pjesmarrja në votim ishte më e madhe, votuesit i plotësonin fletët e votimit në tavolina të vendosura jashtë dhomave të fshehta. Kryetarët e komisioneve të qendrave të votimit e lejonin këtë gjë sistematikisht dhe gjithashtu lejonin pjestarët e së njëjtës familje të hynin në dhomën e fshehtë së bashku.

## **Ukraina**

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale në Ukraine (31 tetor dhe 14 nëntor 1999)*

*Asambleja Parlamentare, Dok. 8603, 21 dhjetor 1999*

Vazhdon të ekzistojë tradita për mosrepektimin e votës së fshehtë dhe për votimin familjar. Pakujdesia në trajtimin e fletëve të votimit dhe kutitë e votimit shkaktoi shumë parregullsi, por jo në atë masë sa të shkaktonte vështirësi, me përjashtim të disa qendrave të votimit. Eshtë gabim që personeli i milicisë vazhdon të ketë të drejtë të hyjë në qendrat e votimit (*raundi i parë*).

Vëzhgimi i raundit të dytë të këtyre zgjedhjeve tregoi se procedurat ligjore e ditës së votimit nuk u respektuan aq rigorozisht sa në raundin e parë. Në raundin e parë vëzhguesit ishin përgjithësisht të kënaqur me procedurat e votimit, pavarësisht nga disa parregullsi të vogla. Në raundin e dytë, vëzhguesit panë raste të shkeljeve më serioze. Në veçanti, vëzhguesit panë në Lviv oblast se në disa qendra votimi, që ata vëzhguan në zonat rurale, votuesve u jepeshin më shumë se një fletë votimi. Ata vunë re gjithashtu raste të votimit familjar dhe shkeljet të fshehtësisë së votës (*raundi i dytë*).

*Zgjedhjet parlamentare, 29 mars 1998*

*OSCE/ODIHR*

Misioni i vëzhgimit është i shqetësuar për numrin e madh të rasteve të vëzhguara të votimit familjar dhe në grup. Votimi familjar u konstatua në 59 % të qendrave të votimit të vizituara, ndërsa votimi i hapur u pa në 59 % të qendrave të votimit. Këto nivele janë shumë të larta dhe në të ardhmen duhen bërë të gjitha përpjekjet për reduktimin e këtyre praktikave. Pranohet se disa nga këto raste, veçanërisht në qytetet e mëdha, u shkaktuan nga paaftësia e qendrave të votimit për të administruar numrin e votuesve të tyre.

*Raporti për progresin nga Byroja e Asamblesë dhe Komiteti i Përhershëm – Raport informativ për zgjedhjet parlamentare në Ukrainë (29 mars 1998) Asambleja Parlamentare, Dok. 8059, Shtojca III*

13. Aspekti më i pazakontë i këtyre zgjedhjeve ishte “votimi familjar” (dy ose tre vetë hyjnë në dhomën e fshehtë në të njëjtën kohë), i cili nuk përbënte përjashtim, por ishte një fenomen i përhapur, si dhe fakti se numri i fletëve të votimit në qëndrat e votimit ishte më i madh se numri i votuesve të tyre. Kjo praktikë u justifikua me faktin se qëndrat e votimit u përgatitën për t’ju përgjigjur edhe atyre qytetarëve, të cilët nuk i kishin emrat në listat zyrtare të votuesve.

*Raporti i misionit të CLRAE për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale dhe rajonale në Ukrainë, 29 mars 1998*  
*CLRAE, CG/BUR (4) 132 rev.*

Pjesmarrja prej 70 përqind e votuesve shkaktoi disa vonesa, fenomene të tilla si votimi familjar, si dhe një farë konfuzioni në një numër të kufizuar të qendrave të votimit. Ky konfuzion erdhi edhe si pasojë e asaj që u duk se ishte, në disa vende, mungesë e kutive të votimit.

*Raporti i misionit të CLRAE për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale dhe rajonale në Ukrainë (26 qershor 1994)*  
*CLRAE, CG/BUR (1) 11*

Anëtarët e delegacionet panë burrat që votonin për gratë e tyre, dhe në disa raste panë disa nënshkrime të vendosura pranë një emri në listën e votuesve, çka tregonte se ai kishte marrë fletë votimi për disa persona.

## **Republika Federale e Jugosllavise**

*Raporti për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Mal të Zi, Republika Federale e Jugosllavisë, 22 prill 2001*  
*CLRAE, CG/CP (8) 5 Rev.*

Praktika e votimit familjar nuk u konstatua në ndonjë nivel të dukshëm, me përjashtim të disa rasteve të kufizuara të votimit nga persona të moshuar.

*Zgjedhjet në Asamblenë Kombëtare të Republikës së Serbisë, 23 dhjetor 2000  
OSCE/ODIHR*

Megjithatë, vëzhguesit raportuan se disa komisione të qëndrave të votimit nuk kontrollonin në mënyrë të vazhdueshme dokumentat e identifikimit të votuesit dhe se “fshehtësia” e votës nuk ishte perfekte. Cilësia e dhomave të fshehta ishte e ndryshme dhe disa prej tyre nuk siguronin fshehtësinë. Vëzhguesit panë shpesh raste kur më tepër se një person hynte në dhomën e fshehtë në të njëjtën kohë, kryesisht anëtarë të një familje, çka ulte shkallën e fshehtësisë së votës. Këto probleme u konstatuan kryesisht në zonat rurale.

*Komiteti ad hoc për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale në Asamblenë  
Kombëtare të Serbisë, Republika Federale e Jugosllavisë  
Asambleja Parlamentare, Dok. 8934, 22 janar 2001*

14. Me qëllim që të shmangej votimi dy herë, votuesve ju lyhej një gisht me një bojë të veçantë, e cila mund të shihej me anë të një llampe me rreze ultraviolet. Ishte hera e parë që përdorej një sistem i tillë dhe votuesit reagonin në mënyra të ndryshme ndaj saj, nganjëhere e kundërshtonin atë. Testi u përdor sistematikisht, por votuesit mendonin se ai përbente një çenim -të dinjitetit qytetar. Ne vumë re gjithashtu se votimi familjar ishte një praktikë e zakonshme, kryesisht në rastet e çifteve, të cilat, sidoqoftë, votonin në dhoma te veçanta të fshehta.

*Raporti për zgjedhjet në Serbi, Republika Federale e Jugosllavisë, 23 dhjetor  
2000  
CLRAE, CG/BUR (7) 85*

Votimi në grup apo familjar u vu re në disa raste, por ai kufizohej kryesisht në votimin e bashkëshortit dhe bashkëshortes.

*Zgjedhjet lokale në Kosovë, 28 tetor 2000  
CLRAE, CG/BUR (7) 63*

32. U vu re votimi familjar, por përgjithësisht kufizohej kryesisht në votimin e dy vetëve. Shumë njerëz thanë se ishin analfabetë dhe, për këtë arsye, kërkonin ndihmë për votim. Kjo nuk u përmend në raporte, megjithë udhëzimet që ishin dhënë për këtë qëllim. Megjithatë u vu re një rast kur kryetari i qendrës së votimit qëndronte mbrapa dhomës së fshehtë, me autorizimin e mbikqyrësit ndërkombëtar, për të ndihmuar njerëzit që pretendonin se ishin analfabetë, megjithëse askush nuk lejohej t'i jepte një

ndihme të tillë më shumë se një personi – dhe kjo ndihmë nuk duhej të jepej nga stafi i qendrës së votimit.

*Raporti për vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Podgoricë dhe Herceg Novi (Mal të Zi, Republika Federale e Jugosllavisë), 11 janar 2000*  
*CLRAE, CG/Bur (7) 45*

U konstatuan disa raste të votimit familjar, por nuk mund të thuhet se ato patën ndonjë efekt në rezultatet e votimit. Anëtarët e komisioneve zgjedhore ishin të kujdesshme për t'a kufizuar këtë praktikë vetëm në rastet kur ishte absolutisht e nevojshme (si në rastet e votuesve të verbër apo me paaftësi të tjera).

*Zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë, 31 maj 1998*  
*OSCE/ODIHR*

A patë raste të votimit familjar?

Po: 19.8 %

Jo: 80.4 %

Votimi familjar është ende një praktikë e përhapur.

*Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në Republikën e Sërbisë, 21 shtator dhe 5 tetor 1997*  
*OSCE/ODIHR*

Vëzhgimet e tjera përfshinin votimin e hapur jashtë dhomës së fshehtë (13 %), më tepër se një person në dhomën e fshehtë (23 %) dhe votimi pa dokument përkatës identifikimi (16 %).

## **Shtojce: Rekomandimi 111 (2002) i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale te Evropes, mbi të drejtat individuale të Votimit të grave – një domosdoshmeri demokratike<sup>1</sup>**

Kongresi,

1. Duke kujtuar deklaratën e miratuar në Konferencën e 4 Ministeriale Evropiane për Barazinë midis Grave dhe Burrave (Stamboll 1997), dhe, veçanërisht, angazhimin që “zbatimi i barazisë midis grave dhe burrave të bëhet pjesë e monitorimit të përbushjes së detyrimeve demokratike nga vëndet anëtare”;
2. Duke kujtuar rolin e Këshillit të Evropës në nxitjen dhe ruajtjen e standarteve më të larta të praktikës demokratike në vëndet anëtare;
3. Duke theksuar se vëndet anëtare të Këshillit të Evropës janë angazhuar me kushtetutë dhe në ligjet e tyre të respektojnë praktika demokratike elektorale, duke përfshirë të drejta të barabarta midis grave dhe burrave në votim;
4. Duke iu referuar instrumentave përkatës ndërkombëtare, veçanërisht Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (1979) dhe Deklaratës dhe Platformës për Veprim të miratuar në Konferencën e 4 Botërore për Gratë (Pekin, 1995);
5. Duke kujtuar se garancia për votim të fshehtë, e përcaktuar në Protokollin Shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Dokumentin e Kopenhagenit i miratuar në vitin 1990 nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), është një kusht themelor që siguron shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës;
6. Duke patur parasysh konkluzionet e raporteve të misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve të kryera nga Asambleja Parlamentare, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe OSBE gjatë viteve të fundit, të cilat kanë identifikuar praktikën e votimit familjar në afro 15 vënde Evropiane;

---

1. Debatuar dhe Diskutuar nga Kongresi në 6 Qershor 2002, Mbledhja e trete (Shiko Doc. CG(9) 7, Draft Rekomandim prezantuar nga Mrs. D. Bunyan, Raporter).

7. Duke kujtuar raportin e Z. Georges Clerfayt dhe Rezolutën e Asamblesë Parlamentare 1264 (2001) për kodin e praktikës së mirë në çështje elektorale;
8. Duke theksuar, në këtë kuadër, se të drejtat individuale të grave për votim janë një nga parimet e sistemeve elektorale Evropiane;
9. Duke afirmuar se ushtrimi i të drejtave individuale të grave për votim është një kërkesë themelore për funksionimin e demokracisë dhe nuk duhet konsideruar si një çështje e dorës së dytë;
10. Duke konsideruar se votimi familjar është një praktikë, e cila tenton t'i privojë gratë, dhe nganjëherë të rinjtë, nga të drejtat e tyre individuale për votim dhe, si e tillë, përbën një formë të manipulimit elektoral;
11. Duke qënë i vetëdijshëm se votimi familjar është një çështje e vështirë dhe e ndjeshme për shtetet që e kanë këtë praktikë;
12. Duke patur parasysh se faktorët social-ekonomik, kulturor dhe lokal përdoren në disa raste për të justifikuar mohimin e të drejtave individuale për votim;
13. Duke besuar se eliminimi i praktikës së votimit familjar kërkon një përpjekje të koordinuar nga aktorë të ndryshëm – autoritetet kombëtare, rajonale, dhe lokale, organizatat jo-qeveritare (OJQ) dhe autoritetet gjyqësore;
14. Duke marrë parasysh se veprimtaritë e kryera nga Grupi i Posaçëm për Gjinitë i Paktit të Stabilitetit dhe veprimtaritë e mbështetura nga OSBE-ja në këtë fushë janë të dobishme për të rritur ndërgjegjësimin e grave për rolin që mund të luajnë për parandalimin e konfliktit dhe krijimin e stabilitetit në rajon;
15. Duke mirëpritur hapat e marra nga Këshilli i Evropës për të nxitur pjesmarrjen e grave në jetën publike, e cila përfshin domosdoshmërisht të drejtën për pjesmarrje, mbi baza individuale, në vendim-marrje, dhe, para së gjithash, në zgjedhje;
16. I bën thirrje vendeve anëtare të Këshillit të Evropës:
  - a. të zbatojnë plotësisht ligjin zgjedhor si pjesë e procesit demokratik në vendet anëtare dhe të sigurojnë respektimin e angazhimeve të marra në kuadrin e ligjeve elektorale;

- b. për këtë arsye, t'i kushtojnë vëmendje të veçantë parandalimit të votimit familjar gjatë trajnimeve të komisioneve zgjedhore;
- c. të deklarojnë publikisht dhe të bëjnë gjërësisht të njohur se gratë kanë të njëjtën të drejtë për votim si burrat dhe, si pasojë, ndalohet çdo privim i të drejtës së grave për të hequr te drejten e votës së tyre;
- d. të kryejnë fushata publike informative para zgjedhjeve, duke theksuar rëndësinë e të drejtës individuale për votim dhe faktin se votimi familjar është një praktikë e papranueshme dhe e paligjshme. Fushata të tilla mund të jenë në formën e edukimit të fokusuar në të drejtat e grave, por mund të jenë gjithashtu në formën e programeve të edukimit të publikut të gjërë për demokracinë, duke përdorur gratë në poste vendim-marrëse si shembuj për pjesmarrje në procesin demokratik të vendim-marrjes;
- e. të nxisin studimet për shkaqet dhe shtrirjen e votimit familjar, dhe, mbi bazën e konkluzioneve të tyre, të hartojnë programe kombëtare për eliminimin e praktikave të tilla, me afate kohore, objektiva dhe mekanizma monitorimi;
- f. të zbatojnë dhe të mbështesin praktika të mira lidhur me procedurat elektorale;
- g. të ftojë ministrat përgjegjës për ligjin elektoral dhe të drejtat e grave të marrin masa përkatëse për të parandaluar votimin familjar;
- h. të marrin masat e nevojshme në mënyrë që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:
  - i. ligji elektoral duhet të përmbajë një dispozitë, në bazë të së cilës zyrtarët e komisioneve zgjedhore mbajnë përgjegjësi për çdo rast të neglizhencës në praktikat zgjedhore dhe, veçanërisht, në ushtrimin e të drejtave individuale të grave për votim;
  - ii. zyrtarët e komisioneve elektorale duhet të jenë të vetëdijshëm se ndaj tyre do të merren masa të ashpra ndëshkimore në rast se në qendrat e votimit, për të cilat ato janë përgjegjës, zbulohen raste mashtrimi. Masa të tilla do të zbatohen për rastet e votimit familjar si dhe për shkelje të tjera të ligjit elektoral;
  - iii. zyrtarët e komisioneve elektorale duhet të jenë plotësisht të trajnuar në zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, ku theksi të vihet në rëndësinë e votimit individual dhe fshehtësinë e votimit, si dhe në nevojën e tolerancës zero për praktika që shkelin këto parime;



- iv. zyrtarët e komisioneve elektorale duhet të kenë ambiente dhe personel të përshtatshëm në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me praktikat më të mira demokratike;
- v. komisionet elektorale duhet të zbatojnë me rigorozitet procedurat demokratike;
- vi. fletët e votimit duhet të plotësojnë nevojat e votuesve (për shembull, fletë votimi në dy gjuhë, të tregohen simbolet e partive në fletët e votimit) për të ndihmuar votuesit analfabetë ose që nuk kanë patur mundësi të kenë informacion të mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të tyre;
- vii. procedurat ankesave duhet të jenë lehtësisht të zbatueshme, të lehta për t'u kuptuar dhe të shpejta, si dhe duhet të përfshijnë një procedurë të efektshme hetimore;
- viii. kur bëhet emërimi i komisioneve elektorale duhet të tregohet kujdes për emërimin e zyrtarëve jo-vendas në zonat ku ka më shumë të ngjarë të ndodh votimi familjar (për shembull, zonat rurale);
- i. t'u kërkojnë partive politike të zhvillojnë programe edukative për demokracinë, duke përfshirë module për barazinë midis seksve me qëllim që të përmbushin kërkesat për financime nga shteti;
- j. të japin arsimim në shkolla për të drejtat e përgjithshme qytetare dhe barazinë, duke e vënë theksin në të drejtat e barabarta të grave me burrat në fushat politike, qytetare, shoqërore dhe ekonomike. Kur është e përshtatshme, këto programe duhet të trajtojnë traditat lokale si dhe praktikat dhe konceptet kulturore, të cilat i detyrojnë gratë dhe vajzat të kenë një rol të dorës së dytë në shoqëri;
- k. të pranojnë se arsimimi duhet të jetë e drejtë bazë për të gjithë, ku gratë dhe vajzat, pavarësisht nga gjendja e tyre, duhet të kenë mundësi të barabartë për arsim të plotë;
- l. të mbështesin dhe lehtësojnë aktivitetet e OJQ-ve, të cilat synojnë që të:
  - i. nxisin arsimimin e grave dhe ushtrimin e të drejtave të tyre themelore, duke përfshirë të drejtat individuale për votim dhe;
  - ii. rrisin ndërgjegjësimin e burrave për rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre individuale për votim;

- m.* të inkurajojnë, me të gjitha mjetet e përshtatshme, OJQ-të e grave që të lidhen me OJQ-të që punojnë për zhvillimin e demokracisë, me qëllim që të koordinohen përvoja, njohuritë dhe strategjitë e nevojshme për të mbështetur të drejtat individuale të grave për votim;
  - n.* të mbeshtesin shtrirjen e projekteve për rritjen e ndërgjegjësimit politik si fushata “Gratë mund t’ia dalin mbanë” dhe programeve për rritjen e rolit politik të grave, të hartuara nga Grupi i Posaçëm për Gjinitë i Paktit të Stabilitetit në vendet ku votimi familjar është problem;
17. I bën thirrje Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës:
- a.* të hartojë një program të koordinuar veprimi për parandalimin e votimit familjar dhe të hartojnë nisma për të ndihmuar institucionet dhe individët të përdorin praktika demokratike, vecanërisht, si pjesë e projekteve të integruara të Këshillit të Evropës “Funksionimi i institucioneve demokratike”;
  - b.* t’i bëjë thirrje Komitetit Drejtues për Barazinë midis Grave dhe Burrave (CDEG) për përfshirjen e kësaj çështje në programin e punës së CDEG-së dhe, në veçanti:
    - i.* të përgatisë dhe shpërmdajë gjërësisht një përmbledhje të praktikave të mira dhe strategjive për arritjen e përfaqësimit të barabartë të sekseve në vendim-marrjen politike dhe sociale dhe të nxisin masa praktike parandaluese për të eliminuar votimin familjar;
    - ii.* të zhvillojë seminare për rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat politike të grave dhe ushtrimin e të drejtave individuale për votim, në bashkëpunim me OJQ lokale që punojnë për barazine midis sekseve, me agjencise që punojnë për forcimin e demokracisë dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale. Këto aktivitete mund të zhvillohen kryesisht në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, programeve të asistencës për vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe programeve para apo mbas antërësisë për vendet që do të bëhen apo që sapa janë bërë anëtare;
    - iii.* të zhvillojë seminare shumëpalëshe rajonale për kryetarët e komisioneve elektorale lokale për të nxitur shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira dhe të nxisin organizimin e kurseve trajnuese për trajnerët e komisioneve elektorale kombëtare dhe lokale në vendet në fjalë;
  - c.* të mbështese aktivitete të organizatave jo-qeveritare të specializuara në forcimin e demokracisë dhe në barazinë midis sekseve, me qëllim që të

- rritet ndërgjegjësimi, në nivel lokal, për të drejtat e grave si anëtare aktive të shoqërisë, duke përfshirë të drejtat e tyre për votim;
- d. të mbështesë, në veçanti, OJQ-të lokale të anagazhuara në monitorimin e zgjedhjeve dhe të tërheqin vëmendjen e tyre ndaj problemit të votimit familjar;
- e. t'ja përcjellë këtë rekomandim Konferencës së 5 të Ministrave të Specializuar, që do të zhvillohet në Shkup më 21 dhe 22 Qershor 2002 për “demokracinë, parandalimin e konflikteve dhe forcimin e paqes: perspektiva dhe roli i grave”;
18. Fton Komisionin e Venecias të trajtojë problemin e të drejtave individuale të grave për votim kur të bëjë vleresime të zgjedhjeve si dhe kur të hartojë kodin e praktikës së mirë për çështjet elektorale, në konsultim me Asamblesë Parlamentare dhe Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës;
19. I bën thirrje Asamblesë Parlamentare:
- a. të tërheqë vëmendjen ndaj fenomenit negativ të votimit familjar gjatë punës së komiteteve të saj përkatës, në veçanti, Komitetit të Çështjeve Politike, Komitetit të Çështjeve Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, dhe Komitetit për Shanse të Barabarta midis Grave dhe Burrave;
- b. të zhvillojë një seancë dëgjimore për votimin familjar dhe të organizojë analiza për praktikën më të mirë dhe për strategji të efektshme mbi rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e grave, të cilat mund të miratohen nga parlamentet kombëtare;
- c. t'i kushtojë vëmendje të veçantë votimit familjar gjatë misionëve të vëzhgimit të zgjedhjeve dhe të theksojë se praktikatat janë të papranueshme në një demokraci;
- d. të sjellë problemin e votimit familjar në qëndër të vëmendjes së komiteteve parlamentare për të drejtat e grave në vendet përkatëse anëtare të Këshillit të Evropës;
20. I bën thirrje Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë dhe Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) t'i kushtojnë vëmendje të veçantë çështjes së votimit familjar kur të zbatojnë veprimtaritë e tyre për “demokratizim” si dhe gjatë misionëve të tyre të vëzhgimit të zgjedhjeve në Evropë.

## Referenca

Komisioni i Komunitetit Evropian, Report from the Commission to the Council, the European Parliament and the Economic and Social Committee on the Implementation of the Council Recommendation 96/694 of 2 Dec. 1996 on the balanced participation of women and men in the decision-making process (Raporti i Komisionit për Këshillin, Parlamentin Evropian, dhe Komitetin Ekonomik dhe Social për Zbatimin e Rekomandimit të Këshillit 96/694 të 2 dhjetorit 1996 për pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në procesin e vendimmarrjes), COM (2000) 120 përfundimtare, Bruksel, 3 korrik 2000

Këshilli i Evropës, *Group of Specialists on Equality and Democracy* (Grupi i Specialisteve për Barazinë dhe Demokracinë), Këshilli i Evropës, Botim, 1996

Këshilli i Evropës, Positive action in the field of equality between women and men (Veprimi pozitiv në fushën e barazisë midis grave dhe burrave, ref. EG-S-PA (2000) 7, Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (Divizioni i Barazisë midis Grave dhe Burrave)

Këshilli i Evropës, Report on local elections observations mission in “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Raport i misionit të vëzhgimit për zgjedhjet lokale në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë), 10-24 shtator 2000 CG/CP (7) 12 rev, Strasburg, 13 nëntor, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës

Këshilli i Evropës, Situation of local democracy in “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Situata e demokracisë lokale në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë), CPL (7) 8 Pjesa II, Strasburg 23-25 Maj 2000, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës

Këshilli i Evropës, Women in politics in Council of Europe member states (Gratë në politikë në vëndet anëtare të Këshillit të Evropës) EG (2000) 4, Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (Divizioni i Barazisë midis Grave dhe Burrave)

Këshilli i Evropës, 4th European Ministerial Conference on equality between women and men (Konferenca e 4 Ministeriale Evropiane për Barazinë midis Grave dhe Burrave) (Stamboll, 13-14 nëntor 1997), “Deklarata mbi barazinë midis grave dhe burrave si kriter themelor i demokracisë”

Këshilli i Evropës, Parliamentary Assembly report on equal representation in political life (Raporti i Asamblesë Parlamentare për përfaqësimin e barabartë në jetën politike), Dok. 8423, Maj 1999

Takimi përgatitor rajonal i ECE për Shqyrtimin 2000 të Zbatimit të Platformës së Pekinit për Veprim, 19-21 janar 2000, Gjenevë, Konkluzione të Miratuara

Adresa e internetit për Paktin e Stabilitetit Zyra e Çështjeve Gjinore, website: [www.spgtf.org](http://www.spgtf.org)

Kombet e Bashkuara, Raporti për Zhvillimin Njerëzor, 2001, [www.undp.org/hdr2001](http://www.undp.org/hdr2001)

Kombet e Bashkuara, Platform for action and Beijing Declaration (Platforma për Veprim dhe Deklarata e Pekinit), Nju Jork: Kombet e Bashkuara, 1996